



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 657 Akti

Nr. 705 Vendimi  
Tiranë, më 18.10.2023

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Olsi Komici</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Firdes Shuli</b>	<b>Relatore</b>
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	<b>Anëtare</b>

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datat 13.10.2023 dhe 18.10.2023, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Kujtim Bashaj**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Kujtim Bashaj, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

## VË R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

**1.** Z. Kujtim Bashaj është subjekt rivlerësimi sipas nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

**2.** Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 15.12.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Kujtim Bashaj do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Firdes Shuli dhe Valbona Sanxhaktari. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli. Në vijim, nga relatorja e çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016.

**3.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: (i) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016; (ii) Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; (iii) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

**4.** Me vendimin nr. 1, datë 15.1.2021, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Kujtim Bashaj, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisionerin Olsi Komici. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Subjekti deklaroi në rrugë elektronike se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

**5.** Me vendimin nr. 2, datë 25.9.2023, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, pasi u njoh prej relatores së çështjes me rezultatet e hetimit dhe me provat e grumbulluara për të tria kriteret, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Kujtim Bashaj; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**6.** Në datën 25.9.2023, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ për të tria kriteret; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë sqarime mbi konstatimet e Komisionit, jo më vonë se data 9.10.2023; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative.

**7.** Në datën 27.9.2023, subjekti i rivlerësimit ka marrë kopje të akteve të dosjes.

**8.** Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, me vendimin nr. 3, datë 10.10.2023, trupi gjykues vendosi kalimin në seancë dëgjimore.

**9.** Në datën 13.10.2023, u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT**

**10.** Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**11.** Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

**12.** Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

**13.** Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, duke marrë në analizë: (i) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe dokumentet shpresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (ii) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar nga AKSIK-ja dhe dokumentet shpresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (iii) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja dhe dokumentet shpresore të paraqitura prej tyre; (iv) provat shpresore/dokumentet e vëna në dispozicion nga institucionet apo subjektet publike a private; (v) denoncimet e publikut sipas nenit 53 të ligjit dhe çdo informacion të marrë në rrugë ligjore; (vi) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit; (vii) sugjerime/opinione të vëzhguesit të ONM-së sipas nenit 49, pikat 10-12 të ligjit.

## **III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI**

### **Vlerësimi i pasurisë**

**14.** Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Kujtim Bashaj ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e pasurisë në datën 26.1.2017, pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, z. Kujtim Bashaj është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, kur ka dorëzuar deklaratën përpara fillimit të detyrës (në vijim DPF) me nr. indeksi \*\*\* dhe në vijim, ka dorëzuar rregullisht deklaratat periodike vjetore (në vijim DPV).

**15.** ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Kujtim Bashaj, ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni për të justifikuar pasuritë; (iii) ka mosdeklarime ndër vite; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

**16.** Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit Kujtim Bashaj, si dhe të personave të lidhur me të.

**17.** Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur në deklaratat periodike vjetore (në vijim DPV) dhe në deklaratën *Vetting*; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarimeve të rreme; (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim vërtetimin ose jo të deklarimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

### **Pasuri të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit**

**18. Apartament banimi 3+1, me sipërfaqe 131 m<sup>2</sup>,** porositur me kontratën (deklaratë noteriale) nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.8.2005, noteri M. M. Tiranë. Apartamenti ndodhet në rrugën “\*\*\*\*” (\*\*\*), godina \*\*\* dhe \*\*\*-katëshe, kati i \*\*\*-të (banim), Tiranë dhe është blerë me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.1.2007, noteri F. L., Tiranë. Apartamenti është i regjistruar në ZVRPP Tiranë me nr. pasurie \*\*\* në zonën kadastrale nr. \*\*\*. Adresa e apartamentit është rruga “\*\*\*\*” (\*\*\*), h. \*\*\*, Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*, Tiranë. Apartamenti është blerë në shumën 52.440 euro, i përlllogaritur në kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.1.2007, noteri F. L., Tiranë. Në bashkëpronësi të familjes në pjesë të barabartë. Burimi i krijimit: shitjen e apartamentit me sip. 70 m<sup>2</sup> me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.8.2005, në vlerën 4.000.000 lekë; (ii) kredi bankare në Raiffeisen Bank në vlerën 2.000.000 lekë, disbursuar me datë 19.8.2005; (iii) hua në shumën 2.000.000 lekë, marrë shtetasit S. N. pa akt shkresor dhe pa interes.

### **19. ILDKPKI-ja ka konstatuar:**

- Është e paqartë vlera e apartamentit me sip. 70m<sup>2</sup>, rruga “\*\*\*\*” (N. L.), Tiranë, pasi sipas deklaramit të subjektit në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë 2005 dhe deklaratës noteriale datë 31.8.2005 është 67.069 euro, ndërsa sipas kontratës së shitjes datë 8.1.2007 dhe deklaratës *Vetting* është 52.440 euro.

- Deklarim i pasaktë i vlerës së apartamentit me sip. 70 m<sup>2</sup> në deklaratën e interesave privatë para fillimit në detyrë 2003, pasi është deklaruar nga subjekti 12.000 USD, ndërsa sipas kontratës së shitblerjes vlera është 15.600 USD.

- Mospërputhje midis kontratës së shitjes së apartamentit me sip. 70 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, datë 23.1.2001, sipas së cilës vlera 15.600 USD është likuiduar jashtë zyrës noteriale dhe kontratës së huas datë 11.5.2001, në shumën 12.000 USD për financimin e kështit të fundit të çmimit të blerjes së apartamentit.

- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e krijimit të huas në shumën 2.000.000 lekë në vitin 2005 dhe 2.500.000 lekë në vitin 2007, shuma të cilat janë përdorur si burim për blerje apartamenti në Tiranë dhe shlyerjen e kredisë për blerjen e tij, pasi organet tatimore nuk konfirmojnë dividend për periudhën nga ushtrimi i aktivitetit privat të huadhënësve.

### **Hetimi i Komisionit**

**20.** Në lidhje me këtë pasuri, ZVRPP Tiranë dhe ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri nuk e kanë konfirmuar pronësinë në emër të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur me të (kjo pasuri rezultoi se është shitur në vitin 2022), por në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka paraqitur kopje të certifikatës së pronësisë dhe të kartelës për pasurinë nr. \*\*\* për apartamentin me sip. 131.1 m<sup>2</sup>, në pronësi të z. Kujtim K. Basha. Në përgjigje të pyetësorit nr.

2 paraqiti shkresën datë 26.1.2017 të ZVRPP-së që vërteton pasurinë nr. \*\*\*, inventarin e dosjes së apartamentit, si dhe kopje certifikate dhe kartelet në emër të tij. Po në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti dokumentoi lidhjen e kontratës me FSHU-në dhe UKT-në në emër të tij.

## **21. Në lidhje me mënyrën e fitimit të pronësisë dhe çmimin e shitjes nga aktet në dosje<sup>1</sup>, rezultoi se:**

**21.1.** Sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.8.2005, palët, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe Kujtim Basha, i datëlindjes 31.12.1961, deklarojnë se shoqëria po ndërton me shpenzimet e veta një pallat, nga i cili subjekti ka porositur një apartament në katin e dytë me sipërfaqe ndërtimi 142.7 m<sup>2</sup>, përfshirë muret, shkallët, ballkonet, ambientet e tjera me çmim 470 euro/m<sup>2</sup>. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, e cila përbën provë të plotë shkresore, është bërë likuidimi i plotë. Afati i përfundimit është deri më 30.9.2005.

**21.2.** Në DPV-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar apartament banimi me sip. 142.7 m<sup>2</sup>, ende i pahipotekuar, vlerën 67.069 euro dhe pjesën takuese 50%.

**21.3.** Sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.1.2007, pala shitëse shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.<sup>2</sup> i shet palës blerëse Kujtim Basha, i datëlindjes 31.12.1961, lindur në Tropojë, një apartament me sipërfaqe prej 131.1 m<sup>2</sup>, me çmim 400 euro/m<sup>2</sup> e barabartë me 52.440 euro, shumë e cila është likuiduar totalisht jashtë zyrës. Në këtë kontratë nuk ka asnjë parashikim në lidhje me ndryshimin e çmimit të shitjes dhe shkaqet që kanë çuar në një ulje të ndjeshme të çmimit të shitjes.

**21.4.** Në DPV-në e vitit 2006, dorëzuar më 27.3.2007, subjekti ka deklaruar se *apartamenti i deklaruar vitin e kaluar tani është me hipotekë nr. \*\*\* dhe sip. 131.1 m<sup>2</sup>*, por pa deklaruar vlerë dhe pjesë takuese, ndërsa në DPV-në e vitit 2007 ka deklaruar se nuk ka ndryshim.

**21.5.** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar blerjen e këtij apartamenti sipas deklaratës noteriale datë 31.8.2005 dhe kontratës datë 8.1.2007, duke përcaktuar vlerën 52.400 euro.

**21.6.** Në përgjigje të pyetësorit standard ka deklaruar blerjen e tij sipas deklaratës noteriale datë 31.8.2005 në vlerën 67.069 euro, duke shpjeguar se kontrata e blerjes datë 8.1.2007 është bërë pas përfundimit të apartamentit, i cili rezultoi me sipërfaqe prej 131.1 m<sup>2</sup> dhe për këtë arsye kanë negociuar çmimin 52.400 euro, i cili ishte paguar tashmë në vitin 2005, ndërsa me diferencën prej 14.629 euro janë paguar garazhet e blera në të njëjtën ndërtesë (trajtuar në paragrafët 43, 44 dhe 45).

**21.7.** Siç vërehet, ka mospërputhje të sipërfaqes së apartamentit dhe çmimit të shitjes midis deklaratës së vitit 2005 dhe kontratës së shitjes së vitit 2007. Subjekti në përgjigje të pyetësorit standard shpjegon ndryshimin e çmimit vetëm me argumentin e zvogëlimit të sipërfaqes së tij nga 142.7 m<sup>2</sup> në 131.1 m<sup>2</sup>. Ky shpjegim nga njëra anë mbetet në nivelin deklarativ pasi nuk është paraqitur ndonjë dokument në kohë reale që të vërtetojë një marrëveshje të palëve për ndryshimet përkatëse të sipërfaqes dhe çmimit dhe, nga ana tjetër, ndryshimet e pretenduara janë të papabuzuara në faktet dhe dokumentet e administruara pasi:

a) Po të merret i mirëqenë shpjegimi i subjektit mbi zvogëlimin e sipërfaqes, nuk shpjegohet zvogëlimi i çmimit për njësi nga 470 euro/m<sup>2</sup> në vitin 2005 (sipas deklaratës) në 400 euro/m<sup>2</sup> në vitin 2007 (sipas kontratës së shitjes). Pra, nëse i referohemi sipërfaqes 131.1 m<sup>2</sup> së përcaktuar në kontratën e blerjes datë 8.1.2007, duke përlllogaritur çmimin për metër katror

<sup>1</sup> Shihni aneksin nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>2</sup> Sipas vërtetimit, në regj. hipotekor nr. \*\*\*, datë 8.9.2006, figuron në pronësi të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., pasuria nr. \*\*\*, ap. nr. \*\*\*, me sip. 131.1 m<sup>2</sup>, në adresën “\*\*\*\*”.

sipas deklaratës së datës 31.8.2005 prej 470 euro/m<sup>2</sup>, çmimi total i apartamentit do të ishte 61.617 euro dhe jo 52.400 euro sa është përcaktuar në kontratën e shitjes.

b) Subjekti nuk ka deklaruar në DPV-të e viteve 2006 dhe 2007 asnjë fakt/marrëveshje të palëve për ndryshimet e pretenduara si zvogëlim të sipërfaqes apo ulje çmimi. Në këto deklarata nuk është deklaruar as vlera e re e pasurisë.

c) Çmimi i blerjes së dy garazheve është 7.488 euro dhe jo 14.629 euro që është diferenca e çmimit të shitjes sipas pretendimeve të subjektit (67.069 euro - 52.400 euro). Pra, mbetet i pakuptimtë deklarimi i subjektit në pyetësin standard që me diferencën prej 14.629 euro janë paguar garazhet e blera në të njëjtën ndërtesë.

ç) Subjekti nuk ka deklaruar në DPV burimin e krijimit të garazheve.

d) Duke qenë se në deklaratën noteriale të vitit 2005 citohet se bashkëngjitur ndodhet planimetria e apartamentit, iu kërkua noterit kopje e plotë e praktikës së deklaratës noteriale përfshirë edhe planimetrinë e apartamentit, i cili me shkresën datë 15.6.2023<sup>3</sup> paraqiti kopje të deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.8.2005, por bashkëngjitur saj nuk ndodhet planimetria e apartamentit siç citohet në të.

**21.8.** Gjatë procesit iu kërkuan sqarime subjektit në lidhje me ndryshimin e çmimit të shitjes së pasurisë, faktit përse nuk është deklaruar në DPV-në e vitit 2006 ndryshimi i sipërfaqes dhe çmimit të negociuar në 52.400 euro, si dhe, destinacionit të shumës 7.141 euro. Në përgjigje të pyetësit nr. 2, subjekti deklaroi se:

a) Ndryshimi në çmimin e blerjes së apartamentit ka ardhur si rrjedhojë e ndryshimeve të ndërtuesit gjatë ndërtimit të pallatit. Fillimisht, për të plotësuar kërkesën e tij për sipërfaqen e apartamentit, është vendosur bashkimi i dy hyrjeve dhe kur është lidhur deklarata noteriale e datës 31.8.2005, sipërfaqja e planifikuar për t'u bashkuar ishte ajo e deklaruar në këtë deklaratë (142.7 m<sup>2</sup>). Me riorganizimin fizik të apartamenteve, apartamenti ka rezultuar me sipërfaqe 131.1 m<sup>2</sup>, pasqyruar në kontratën e shitjes së datës 8.1.2007. Po kështu, sipas subjektit, me përfundimin e objektit, si pasojë kërkesë-ofertës së kohës dhe kostos përfundimtare, çmimi i apartamentit ka rezultuar më i ulët sesa ai i vitit 2005 për të gjithë blerësit në godinë. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti ka paraqitur: (i) deklaratën noteriale datë 25.7.2023 të investitorit Xh. H., i cili pohon deklaratimet e subjektit duke deklaruar se me mbarimin e pallatit, kolaudimin e tij e adaptimin e dy hyrjeve (1+1) në një, si rezultat i këtij adoptimi arkitektët realizuan një hyrje 3+1, por me një reduktim të sipërfaqes nga 142.7 në 131.1 m<sup>2</sup>; (ii) lejen e ndërtimit të objektit dhe planimetrinë e katit ku janë konturuar dy apartamente 1+1, (sipas subjektit për t'u bashkuar në vitin 2005), si dhe akti e kolaudimit të dorëzuar në ZRVPP, ku paraqitet se punimet kanë përfunduar më 31.7.2005, si dhe sipërfaqja përfundimtare e apartamentit 131.1 m<sup>2</sup> e shfrytëzueshme dhe 8.6 m<sup>2</sup> sipërfaqe e përbashkët, sipërfaqe totale prej 139.7 m<sup>2</sup>. Në këtë akt kolaudimi nuk rezulton asnjë apartament në katin e dytë me sip. 142.7 m<sup>2</sup>. Siç vërehet, subjekti nuk e lidh ndryshimin e çmimit vetëm me zvogëlimin e sipërfaqes sikurse ka deklaruar në përgjigje të pyetësit standard.

b) Në lidhje me mosdeklarimin e ndryshimit të sipërfaqes së apartamentit në DPV-në e vitit 2006 subjekti sqaron se pavarësisht se nuk ka një deklaratë të tillë, në rubrikën "Pasuri..." ka deklaruar se apartamenti i deklaruar vitin e mëparshëm është me hipotekë dhe sipërfaqe 131.1 m<sup>2</sup> dhe se deri në atë moment, për shkak të mirëbesimit nuk ishte ndërmarrë ndonjë veprim monetar me investitorin e objektit duke qenë në bashkëbisedim për garazhet në të njëjtën ndërtesë.

c) Sa i takon destinacionit të shumës 7.141 euro, e mbetur pas rakordimeve për shkak të çmimit përfundimtar të shitjes së apartamentit, subjekti deklaroi se i është kthyer gjatë vitit 2007 dhe u depozitua në llogari bankare për t'u përdorur më pas në vitin 2008 për studimet e vajzës.

<sup>3</sup> Shihni shkresën datë 15.6.2023 të noterit B. Gj. V. në dosjen e Komisionit.

**21.9.** Në analizë të fakteve të renditura si më sipër, as me deklaratimet e subjektit dhe as me ato të shtetasit Xh. H. nuk vërtetohet ndryshimi i sipërfaqes dhe çmimit të shitjes së apartamentit sikurse subjekti pretendon. Përkundrazi, akti i kolaudimit, që paraqet sipërfaqen ndërtimore përfundimtare të apartamentit 131.1 m<sup>2</sup> (pa përfshirë ambientet e përbashkëta 8.6 m<sup>2</sup>) aq sa është përcaktuar në kontratën e shitjes 2007 ashtu edhe në regj. hipotekor nr. \*\*\*, datë 8.9.2006, përforcon bindjen se kjo kontrata e shitjes e vitit 2007 i referohet sipërfaqes së brendshme të apartamentit pa përfshirë ambientet e përbashkëta. Për më tepër, në deklaratën e vitit 2005 parashikohet qartë se *subjekti ka porositur një apartament në katin e dytë me sipërfaqe ndërtimi 142.7 m<sup>2</sup>, përfshirë muret, shkallët, ballkonet dhe ambientet e tjera*. Në këto kushte, sipërfaqja e përcaktuar në deklaratën e vitit 2005 është sipërfaqe bruto ku përfshihen edhe sipërfaqe të përbashkëta të pallatit si shkallët, ashensori, etj., ndërkohë që sipërfaqja në kontratën e vitit 2007 është sipërfaqja neto e regjistruar edhe në ZVRPP, sikurse ndodh në praktikë, logjikisht më e vogël.

**21.10.** Po kështu, subjekti është kontradiktor në deklaratime pasi në përgjigje të pyetësorit standard ka deklaruar se me diferencën e pretenduar nga ulja e çmimit prej 14.629 euro janë paguar garazhet, ndërkohë që të dyja garazhet kanë kushtuar 7.488 euro. Vetëm në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar në lidhje me kthimin e shumës 7.141 euro nga ndërtuesi gjatë vitit 2007 për shkak të ndryshimit të çmimit të shitjes, ndërkohë që në DPV-në për këtë vit nuk ka deklaruar shtesë likuiditeti në këtë shumë. Për më tepër, subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të garazheve në DPV-në përkatëse.

**21.11.** Bazuar në sa më sipër, nuk justifikohet ulja e çmimit të shitjes nga 67.069 euro në 52.440 euro e, për këtë arsye, si çmim i apartamentit objekt verifikimi me të gjitha pjesët e tij përbërëse është konsideruar shuma 67.069 euro, paguar në vitin 2005 sipas deklaratës noteriale të këtij viti. Në këto kushte dhe në konsideratë të deklaratës noteriale të vitit 2005 kur subjekti ka deklaruar likuidimin e shumës 67.069 euro, është kryer analiza financiare për mundësinë e krijimit të kësaj shume me të ardhura të ligjshme në momentin e redaktimit të deklaratës noteriale të vitit 2005. Sa i takon garazheve, është kryer analiza financiare për blerjen e tyre në momentin e përfitimit të tyre (trajtuar në paragrafët 43, 44 dhe 45).

**22.** Sa i takon trajtimit të mundshëm preferencial në blerjen e kësaj pasurie, sipas udhëzimit nr. 5, datë 23.11.2005, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja për vitin 2005”, për qytetin e Tiranës çmimi i referencës për vitin 2005 është 77.452 lekë/m<sup>2</sup>. Referuar këtij çmimi, apartamenti i blerë do të kushtonte 142.7 m<sup>2</sup> x 77.452 m<sup>2</sup> = 11.052.400 lekë, ndërkohë që subjekti ka shpenzuar për të shumën 67.069 ose 8.259.547 lekë (rreth 75% të çmimit të referencës). Vërehet se subjekti e ka blerë pasurinë më lirë se çmimi i referencës.

**22.1.** Iu kërkua subjektit të paraqesë kontrata të ngjashme, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2 paraqiti tri fotokopje kontratash shitjeje apartamentesh në të njëjtën godinë, të lidhura në vitin 2007. Në kushtet që të tria këto kontrata janë lidhur në vitin 2007 ndërkohë që subjekti ka porositur dhe ka paguar çmimin e shitjes në vitin 2005, nuk mund të bëhet krahasimi i çmimit të tyre me çmimin e apartamentit të blerë nga subjekti. Nga ana tjetër, nuk qëndron pretendimi i subjektit se çmimi për 1 m<sup>2</sup> është ulur në vitin 2007. Përkundrazi, ky çmim ka pësuar rritje.

**22.2.** Pas verifikimeve të kryera<sup>4</sup> nuk rezultoi konflikt interesi me shtetasin Xh. S. H. dhe shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. apo përfshirje në veprimtari të krimit të organizuar, megjithatë subjekti në DPV-në e vitit 2017 ka deklaruar se shtetasi Xh. H. është biznesmen, mik i ngushtë i familjes prej më shumë se 20 vitesh, pasi në këtë vit i kishte marrë një hua prej 20.000 USD.

**23. Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë rezultoi se:**

---

<sup>4</sup> Shihni shkresat: nr. \*\*\* prot., datë 27.6.2023, të PGJSHJPJ-së Dibër; nr. \*\*\* prot., datë 26.6.2023, të PGJSHJPJ-së Shkodër; nr. \*\*\* prot., datë 6.7.2023, të PGJSHJPJ-së Lezhë; nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2023, të PGJSHJPJ-së Durrës; nr. \*\*\* prot., datë 4.7.2023, të SPAK-ut në dosjen e Komisionit.

- Në DPV-të e viteve 2005, 2006 dhe 2007 subjekti nuk ka deklaruar burimin e pasurisë, ndërsa në shpjegimet e dhëna në vitin 2016 pranë ILDKPKI-së ka deklaruar si burim ashtu sikurse në deklaratën *Vetting*, konkretisht: (i) shitjen e apartamentit me sip. 70 m<sup>2</sup> me kontratë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.8.2005, në vlerën 4.000.000 lekë; (ii) kredi bankare në Raiffeisen Bank në vlerën 2.000.000 lekë, disbursuar në datën 19.8.2005; (iii) hua në shumën 2.000.000 lekë, marrë shtetasit S. N. pa akt shkresor dhe pa interes, ndërsa në pyetësin standard ka shtuar si burim edhe kursimet e vitit paraardhës.

- I pyetur në lidhje me arsyet e mosdeklarimit të burimeve në DPV-të e viteve 2005, 2006 dhe 2007, në përgjigje të pyetësit nr. 2 subjekti sqaroi se pavarësisht se nuk është bërë shprehimisht një deklaram i burimit të vlerave për blerjen e apartamentit në DPV-në e vitit 2005, ka përkthuar këto vlera që kanë shërbyer si burim në rubrikat respektive të deklaratës si: (i) tek "Pasuria" ka përkthuar apartamentin e blerë; (ii) tek "Të ardhurat" ka përkthuar të ardhurat nga shitja e apartamentit të blerë në vitin 2001; (iii) tek "Detyrimet financiare" kredinë e marrë nga Raiffeisen Bank; (iv) tek "Të dhëna konfidenciale" huan e marrë nga shtetasi S. N.; (v) në DPV-në e vitit 2004 ka deklaruar kursime në shumën 500.000 lekë me burim pagat e tij dhe të bashkëshortes.

### **Analiza e secilit prej burimeve të deklaruara në deklaratën *Vetting***

***Analizë e burimit "Të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip. 70 m<sup>2</sup>, me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.8.2005, në vlerën 4.000.000 lekë"***

**24. Në lidhje me këtë apartament u evidentua se:**

- Sipas vërtetimit në regjistrin hipotekor nr. \*\*\*, datë 28.7.2005, figuron në pronësi të shtetasve Kujtim Basha dhe S. B. apartamenti me sip. 70 m<sup>2</sup>, në rrugën "\*\*\*\*", origjina nr. hip. \*\*\*, datë 26.2.2001 etj. dhe sipas hartës treguese apartamenti ka nr. pasurie \*\*\*.

- Sipas kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.8.2005, shtetasit Kujtim dhe S. Basha i shesin apartamentin me sip. 70 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, në rrugën "\*\*\*\*" shtetasve K. dhe Xh. I. në vlerën 4.000.000 lekë, shumë e cila është likuiduar totalisht jashtë zyrës.

- Në DPV-në e vitit 2005 subjekti ka deklaruar të ardhura nga shitja e shtëpisë me sip. 70 m<sup>2</sup> në shumën 4.000.000 lekë, konvertuar rreth 32.000 euro, si dhe në deklaratën *Vetting* dhe pyetësin standard ka deklaruar shitjen e tij me kontratën nr. \*\*\*, datë 30.8.2005.

- ZVRPP Tiranë dhe ASHK nuk e kanë konfirmuar këtë pasuri në emër të subjektit. Iu kërkua subjektit të paraqesë dokumentacion provues për pagesën e detyrimeve tatimore që rrjedhin nga kontrata e shitjes së apartamentit, i cili në përgjigje të pyetësit nr. 2 paraqiti dokumentacion sipas inventarit të dosjes së ZVRPP-së, ndër të tjera, mandatarkëtimin nr. \*\*\*, datë 30.5.2005, të pagesës së tatimit nga shitja e apartamentit sipas kontratës së shitjes datë 30.5.2005 në shumën 40.000 lekë (1% e çmimit të shitjes)<sup>5</sup>.

**25. Në lidhje me fitimin e pronësisë dhe burimin e krijimit të apartamentit me sip. 70 m<sup>2</sup>, rezultoi se:**

- Sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 23.2.2001 bashkëshortja e subjektit S. B. ka blerë apartamentin me sip. 70 m<sup>2</sup>, rruga "\*\*\*\*", regjistruar në regj. hip. nr. \*\*\*, datë 21.6.2000, Tiranë, me vlerë 15.600 USD, shumë e likuiduar jashtë zyrës noteriale, e cila u regjistrua në emër të saj sipas vërtetimit hipotekor nr. \*\*\*, datë 26.2.2001.

- Në DPDFD-në e vitit 2003, subjekti ka deklaruar apartamentin me sip. 90 m<sup>2</sup>, pjesën takuese 50%, adresa rruga "\*\*\*\*", regj. hip. \*\*\*, datë 26.2.2001. Edhe në deklaratën *Vetting* subjekti e ka deklaruar blerjen e këtij apartamenti me sip. 70 m<sup>2</sup>, me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.2.2001, po ashtu edhe në pyetësin standard.

<sup>5</sup> Tatimi prej 1% mbi të ardhurat nga shitja e apartamentit objekt verifikimi i përcaktuar në kontratën e shitjes është në përputhje me udhëzimin nr. 5, datë 18.1.2005, "Për tatimin mbi të ardhurat" i Ministrisë së Financave.



Sa më sipër, nuk konstatohen problematika në lidhje me origjinën dhe mënyrën e fitimit të pronësisë, ndërsa sa i përket deklarimit të sipërfaqes prej 90 m<sup>2</sup>, në vitin 2003, duket se është lapsus përderisa subjekti e ka referuar regjistrin hipotekor nr. \*\*\*, datë 26.2.2001.

- Sa i takon trajtimin të mundshëm preferencial në blerjen e kësaj pasurie, sipas udhëzimit nr. 5, datë 31.5.2001, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja për vitin 2001”, për qytetin e Tiranës, çmimi i referencës për vitin 2001 është 56.306 lekë/m<sup>2</sup>. Referuar këtij çmimi, apartamenti i blerë do të kushtonte 70 m<sup>2</sup> x 56.306 m<sup>2</sup> = 3.941.420 lekë, ndërkohë që subjekti ka shpenzuar për të shumën 15.600 USD ose 2.244.372 lekë<sup>6</sup> (rreth 56% të çmimit të referencës). Vërehet se subjekti e ka blerë pasurinë më lirë se çmimi i referencës.

**25.1.** Iu kërkua subjektit të paraqesë kontrata të ngjashme, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2 paraqiti disa fotokopje kontratash shitjeje apartamentesh në objektin me nr. pasurie \*\*\*, \*\*\*, z. k. \*\*\*, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë: (i) kontratë shitjeje datë 18.4.2001, e lidhur mes shtetasve R. B. dhe P. M., për shitjen e një apartamenti me sip. 84.5 m<sup>2</sup> në çmimin 17.500 USD; (ii) kontratë shitjeje datë 5.5.2001, e lidhur mes shtetasve R. B. dhe Rr. Xh. etj., për shitjen e një apartamenti me sip. 80 m<sup>2</sup> në çmimin 17.500 USD; (iii) kontratë shitjeje datë 5.5.2001, e lidhur mes shtetasve R. B. dhe E. Sh., për shitjen e një apartamenti me sip. 60 m<sup>2</sup> në çmimin 1.700.000 lekë; (iv) kontratë shitjeje datë 21.3.2001, e lidhur mes shtetasve R. B. dhe M. S., për shitjen e një apartamenti me sip. 70 m<sup>2</sup> dhe garazh me sip. 32 m<sup>2</sup> në çmimin 2.800.000 lekë.

**25.2.** Nga verifikimi i akteve krahasuar me çmimin e shitjes së apartamenteve në tregun e lirë sipas udhëzimit të EKB-së<sup>7</sup> në qytetin e Tiranës për vitin 2001 kur janë blerë apartamentet si më sipër, rezulton se janë blerë më lirë, ndërsa krahasuar me çmimin e shitjes së apartamenteve të paraqitura nga subjekti si më sipër, rezulton i blerë në çmim të përafërt.

**25.3.** Pas verifikimeve të kryera<sup>8</sup> nuk rezultoi konflikt interesi me shtetasit R. Y. B., K. P. I. dhe Xh. M. I. apo përfshirje në veprimtari të krimin të organizuar.

**26. Sa i takon burimit të krijimit të apartamentit me sip. 70 m<sup>2</sup>, blerë në vlerën 15.600 USD, në datën 23.2.2001, rezultoi se:**

**26.1.** Në DPFD-në e vitit 2003, subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në vlerën 12.000 USD (13 milionë lekë). Në këtë deklaratë subjekti shprehet: “Blerë duke shfrytëzuar të ardhurat personale të familjes, si dhe kredi në vlerën 12.000 USD nga Banka Amerikane”.

**26.2.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar saktësisht vlerën e apartamentit 15.600 USD dhe si burim ka deklaruar kredinë e marrë nga bashkëshortja në Bankën Amerikane në shumën 12.000 USD me kontratën datë 11.5.2001, e disbursuar në datat 18.5.2001 dhe 31.5.2001, ndërsa në pyetësorin standard ka deklaruar si burim kursimet e tij dhe të bashkëshortes, si dhe kredinë e marrë në Bankën Amerikane.

**26.3.** Siç vërehet, në DPFD-në e vitit 2003 subjekti ka bërë deklaram të pasaktë të vlerës së apartamentit, por, nisur nga mënyra e deklarimit të burimit ku, përveç kredisë prej 12.000 USD ka deklaruar edhe kursimet familjare, logjikisht vlera e blerjes nënkuptohet më e lartë se ajo e deklaruar, kjo edhe për faktin se vetë kontrata e huas e vitit 2001 e deklaruar në vitin 2003 përcakton se vlera 12.000 USD do të shërbejë për këstin e fundit të apartamentit, pra ka pasur një këst të paguar para kësaj kredie.

## **27. Analizë specifike e secilit burim**

<sup>6</sup> Kursi i këmbimit në datën 23.2.2001 kur është lidhur kontrata e shitjes së apartamentit është USD/lekë = 143.87.

<sup>7</sup> Shihni udhëzim nr. 5, datë 31.5.2001, në faqen zyrtare të EKB-së.

<sup>8</sup> Shihni shkresat: nr. \*\*\* prot., datë 27.6.2023, të PGJSHPP Dibër; nr. \*\*\* prot., datë 26.6.2023, të PGJSHPP Shkodër; nr. \*\*\* prot., datë 6.7.2023, të PGJSHPP Lezhë; nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2023, të PGJSHPP Durrës; nr. \*\*\* prot., datë 4.7.2023, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

**27.1. Sa i takon burimit “kredi”**, subjekti ka paraqitur<sup>9</sup> kontratë huaje datë 11.5.2001 mes Bankës Amerikane dhe huamarrësve S. B. dhe Kujtim Basha, i datëlindjes 13.12.1961, lindur në Tropojë, ku është përcaktuar vlera e huas në shumën 12.000 USD për financimin e kështit të fundit të çmimit të blerjes së një apartamenti të ri, e cila do të disbursohet në dy këste prej 6.000 USD. Për këtë hua është lidhur edhe kontrata e hipotekimit datë 12.5.2001 për apartamentin në rrugën “\*\*\*”, me sip. 70 m<sup>2</sup>, në pronësi të shtetas S. B.

**27.1.1.** Intesa Sanpaolo Bank<sup>10</sup> i ka bashkëngjitur shkresës së saj ekstraktin bankar të llogarisë me nr. \*\*\*, në monedhën dollar, ku verifikohen disbursime në shumën 6.000 USD në datën 18.5.2001 dhe shumën 6.000 USD në datën 31.5.2001. Këto shuma, pas mbajtjes së komisioneve bankare sipas kontratës së kredisë, janë tërhequr *cash* në datat respektive të disbursimeve të kredisë nga bashkëshortja e subjektit.

**27.1.2.** Siç vërehet, kredia në vlerën 12.000 USD është disbursuar pothuajse 3 muaj pasi është lidhur kontrata e blerjes së pasurisë nga bashkëshortja e subjektit, datë 23.2.2001. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti sqaroi se si burim për blerjen e apartamentit ka shërbyer kredia prej 12.000 USD, financuar nga Banka Amerikane sipas kontratës së huas datë 11.5.2001 dhe shuma prej 3.500 USD nga kursime të mbledhura ndër vite prej tij dhe bashkëshortes së tij. Sipas tij, në mungesë të të ardhurave të mjaftueshme dhe të një prone për t’u vendosur si garanci për kredinë në Bankën Amerikane kanë dakordësuar me mirëbesim me shitësin R. B. për të nënshkruar kontratën e shitjes dhe transferimin e titullit të pronësisë në emër të bashkëshortes së tij dhe se, ky shtetas do të priste për shlyerjen e çmimit të shitjes. Në vijim, prona është hipotekuar për shkak të kredisë së marrë në Bankën Amerikane të disbursuar në dy transhe, në datat 18.5.2001 dhe 31.5.2001, në total shumën 12.000 USD. Për të mbështetur këtë fakt, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.7.2023, të shtetasit R. B., i cili pohon deklaratimet e subjektit.

**27.1.3.** Në vlerësim të fakteve e rrethanave si më sipër, njihen raste nga praktika bankare që për arsye praktikiteti, në rast mungese prone për t’u ofruar si garanci hipotekore, palët (blerës dhe shitës) kanë operuar duke dakordësuar transferimin e titullit të pronësisë përpara disbursimit të kredisë. Por, në rastin konkret, nuk vërtetohet që shumat 6.000 euro, të cilat janë tërhequr *cash* nga bashkëshortja e subjektit pas disbursimit të kredisë, të kenë kaluar në favor të shitësit të pasurisë në rrugë bankare ose jo. Në këto kushte, deri në përfundim të hetimit administrativ kredia prej 12.000 USD nuk është konsideruar si burim për blerjen e pasurisë apartament me sip. 70 m<sup>2</sup> në vitin 2001.

### **Sa i takon shlyerjes së kredisë me vlerë 12.000 USD, marrë në Bankën Amerikane në vitin 2001**

**27.1.4.** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se kredia prej 12.000 USD e marrë në vitin 2001 është likuiduar në vitin 2004, pa deklaruar burim të ardhurash. Në DPFD-në e vitit 2003, subjekti nuk ka deklaruar gjendjen e mbetur të kredisë në Intesa Sanpaolo Bank prej 9.856 USD dhe as detyrim financiar për shkak të saj. Ndërsa në DPV-në e vitit 2004 subjekti nuk ka deklaruar pakësim likuiditetesh për shlyerje kredie dhe as shlyerjen e detyrimit të mbetur.

**27.1.5.** Pas verifikimit të të dhënave bankare u konstatua se në datën 23.1.2004, në llogarinë e bashkëshortes së subjektit pranë Bankës Amerikane është depozituar prej saj shuma 9.904 USD dhe, në vijim, shumat 4.938.02 USD dhe 4.918.55 USD janë transferuar për pagesën e principalit të kredive të disbursuara në maj të vitit 2001.

<sup>9</sup> Shihni dokumentacionin në aneksin nr. \*\*\* të dosjes ILDKPKI-së.

<sup>10</sup> Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2021, të Intesa Sanpaolo Bank (që ka blerë Bankën Amerikane).

**27.1.6.** I pyetur nga ILDKPKI-ja në vitin 2016 për burimin e krijimit të depozitës prej 9.904 USD pasi në DPDFD-në e vitit 2003 nuk kishte deklaruar depozitë në bankë apo gjendje *cash*, subjekti ka deklaruar se burimi i krijimit janë pagat e tij dhe të bashkëshortes në vite.

**27.1.7.** I pyetur gjatë procesit në lidhje me burimin e depozitës prej 9.904 USD në Intesa Sanpaolo Bank në datën 23.1.2004, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 sqaroi se shuma 10.000 USD i është dhënë hua bashkëshortes së tij nga shtetasja I. F. dhe bashkëshorti i saj me të cilët kanë marrëdhënie të ngushta, me të ardhura nga shitja e një pasurie, pa ndonjë akt të shkruar, pa interes monetar dhe pa një afat kohor. Subjekti deklaroi se kjo shumë i është kthyer pas ndër vite deri në vitin 2007, por pa dhënë detaje të kronologjisë së shlyerjes së saj. Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale nr. \*\*\* prot., nr. \*\*\* kol., datë 25.7.2023 të shtetasës I. F., e cila deklaroi dhënien e shumës prej 10.000 USD bashkëshortes së subjektit, e krijuar me të ardhura të përfituara nga shitja e një pasurie dhe qiraje, kanalizuar nëpërmjet sistemit bankar, por nuk ka paraqitur asnjë dokument për të provuar të ardhurat e ligjshme prej 10.000 USD.

**27.1.8.** Deklarimi i huas së marrë nga shtetasja I. F. bëhet për herë të parë gjatë procesit të hetimit administrativ, pasi kjo hua nuk është deklaruar as në deklaratat vjetore periodike të periudhës 2004 – 2007 si detyrim financiar, as në deklaratën *Vetting* dhe as në përgjigje të pyetësorit standard. Gjithashtu, nuk është deklaruar as në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI në vitin 2016<sup>11</sup>. Siç vërehet, gjatë hetimit subjekti ka ndryshuar deklarinimin në lidhje me burimin e shumës 9.904 USD, e cila ka shërbyer për shlyerjen e kredisë.

**27.1.9.** Si e tillë, huaja prej 10.000 USD nuk u konsiderua si burim për krijimin e shumës 9.904 USD, depozituar në llogarinë e bashkëshortes në datën 23.1.2004, që ka shërbyer për shlyerjen e balancës së mbetur të kredisë së marrë në Bankën Amerikane në vitin 2001. Për këtë arsye është kryer analiza financiare si në tabelën më poshtë për të verifikuar burimin e ligjshëm financiar të kësaj shume. Meqenëse subjekti nuk ka deklaruar kursime në formë likuiditetesh *cash* në deklaratën vjetore të vitit 2003, në analizën financiare janë konsideruar të ardhurat dhe shpenzimet familjare nga data 1.1.2004 në datën 23.1.2004, si dhe balancat e llogarive bankare.

Përshkrimi	1.1.2004 – 23.1.2004
<b>Pasuritë</b>	<b>-3,578</b>
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>	-3,578
Gjendja e likuiditeteve	713
<b>Të ardhurat</b>	<b>124,304</b>
Paga subjekti	98,149
Paga bashkëshortja e subjektit	26,155
<b>Shpenzimet</b>	<b>1,098,061</b>
Shpenzimet jetike	31,321
Shpenzime pagese kredie (interes)	15,819
Shpenzime shlyerje kredie (23.1.2004)	1,054,307
Shpenzim komision për shlyerje para afatit të huas + komisione bankare	5,486
Shpenzime udhëtimi në vendin e punës	6,947
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>- 970,180</b>

**27.1.10.** Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e depozitës prej 9.904 USD në Intesa Sanpaolo Bank në datën 23.1.2004 e, për rrjedhojë, për të mundësuar shlyerjen e kredisë në datën 23.1.2004, për shkak të balancës negative prej 970.180 lekësh.

**27.2. Sa i takon burimit “të ardhura personale/kursime të familjes”** rezultoi se totali i të ardhurave të subjektit dhe bashkëshortes së tij përgjatë periudhës 1992 – 23.2.2001 kanë qenë në vlerën 3.130.303 lekë, të cilat janë përfshirë si të ardhura të ligjshme.

<sup>11</sup> Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 9.11.2021, të ILDKPKI-së në dosjen e Komisionit.

## Analiza financiare

28. Në vijim të sa më sipër, nga ana e Komisionit është kryer analiza financiare për të verifikuar mundësinë e pagesës prej 15.600 USD/2.244.372 lekësh për blerjen e apartamentit me sip. 70 m<sup>2</sup> sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 23.2.2001, duke konsideruar të ardhurat dhe shpenzimet familjare<sup>12</sup> të akumuluar në periudhën 1993 – 23.2.2001, që është data e nënshkrimit të kontratës.

Përshkrimi	1992 – 23.2.2001
<b>Pasuritë</b>	<b>2,244,372</b>
Apartament me sip. 70 m <sup>2</sup> , Tiranë	2,244,372
Likuiditete	
<b>Të ardhurat</b>	<b>3,130,303</b>
Paga subjekti	2,472,496
Paga bashkëshortja e subjektit	657,808
Të ardhura nga kredia për blerjen e apartamentit	-
<b>Shpenzimet</b>	<b>2,009,498</b>
Shpenzimet jetike	2,009,498
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>- 1,123,567</b>

Nga analiza financiare duket se subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të mundësuar blerjen e apartamentit me sip. 70 m<sup>2</sup> në vitin 2001 për shkak të një balance negative prej 1.123.567 lekësh. Për rrjedhojë, në përfundim të hetimit administrativ, shuma prej 4.000.000 lekësh e përfituar nga shitja e tij në datën 30.8.2005 nuk është përfshirë në analizën financiare si e ardhur e ligjshme për blerjen e pasurisë objekt verifikimi.

Subjektit i kaloi barra e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 94/206, ku duket se nuk u provuan të ardhurat e ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit me sip. 70 m<sup>2</sup>. Për më tepër, subjekti ka ndryshuar deklrimet në lidhje me burimin e të ardhurave për shlyerjen e një kredie që ka shërbyer si burim për blerjen e këtij apartamenti.

### Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

28.1. Sa i takon moskonsiderimit të kredisë prej 12.000 USD të marrë pranë Bankës Amerikane në maj 2001 si burim për blerjen e apartamentit me sip. 70 m<sup>2</sup>, Tiranë, subjekti dha të njëjtat shpjegime si gjatë procesit të hetimit, pa paraqitur dokumentacion të ri.

28.2. Në lidhje me moskonsiderimin e huas prej 10.000 USD të dhënë nga shtetasja I. F., subjekti deklaroi se mban përgjegjësi për sa i përket deklarimeve të tij në lidhje me vlerën 9.904 USD, të përdorur për shlyerjen e menjëhershme të kredisë në vitin 2004, pasi nga ana e tij nuk është deklaruar në mënyrë të saktë për shkak të raporteve të ngushta me huadhënësin dhe mënyrës së shlyerjes, siç realisht ka ndodhur. Për të provuar të ardhurat e ligjshme të huadhënëses I. F., subjekti ka paraqitur: (i) kontratë shitjeje për shitje apartamenti datë 27.11.2000, në vlerën 1.900.000 lekë; (ii) kontratë qiraje jo me akt noterial datë 10.12.1999 me pagesën e vlerës 900 USD/muaj vitin e parë dhe me vlerë 1.100 USD/muaj, në rastin e përtëritjes së kontratës në vitin e dytë; (iii) dy mandatarkëtime për dy nga pagesat *cash* për muajt janar dhe shkurt 2000 nga 900 USD secila; (iv) vërtetim nga OTP Bank (llogari në ish Alpha Bank), datë 5.10.2023 për 7 pagesa prej 1.100 USD secila (total 7.700 USD), të kryera në mënyrë bankare në favor të shtetasës I. F. për muajt janar – korrik 2001. Subjekti konkludon se në rastin e konsiderimit të huas prej 10.000 USD si burim për shlyerjen e kredisë në Bankën Amerikane, rezultati i analizës financiare për vitin 2004 do të kthehej në pozitiv.

28.3. Nga dokumentacioni i depozituar prej subjektit nuk vërtetohen të ardhura të ligjshme të huadhënëses pasi: (i) nuk u provua pagesa e tatimit për 0.5%, siç parashikohet në kontratën e

<sup>12</sup> Shpenzimet jetike deri në vitin 2000 përlllogariten në masën 66% të totalit të të ardhurave sipas standardit të Kolegjit dhe, më pas, sipas standardit të ILDKPKI-së shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.1.2019.

shitjes së apartamentit datë 27.11.2000, pasi minimalisht nuk provohet që kjo kontratë të jetë regjistruar në emër të blerësve; (ii) nuk u provua pagesa e tatimit në burim mbi të ardhurat e përfituara nga qiraja, pasi siç shihet shuma e përfitur nga këto qira është bruto. Për më tepër, të ardhurat i takojnë viteve 1999, 2000 dhe 2001, ndërkohë që huaja e pretenduar i përket vitit 2004.

**28.4.** Por, pavarësisht sa më sipër, por sidomos në kushtet kur në lidhje me huan e marrë nga shtetasja I. F. subjekti ka kryer deklarime për herë të parë gjatë procesit dhe deri në vitin 2007 kur pretendon të ketë shlyer huan nuk ka deklaruar detyrime financiare në asnjë prej DPV-ve, kjo hua nuk mund të konsiderohet si burim për krijimin e depozitës *cash* prej 9.904 USD, datë 23.1.2004, në llogarinë e bashkëshortes së subjektit pranë Bankës Amerikane, nga e cila në vijim shumat 4.938,02 USD dhe 4.918,55 USD janë transferuar për pagesën e principalit të kredisë të disbursuar në maj 2001. Po kështu, subjekti është në kushtet e pamjaftueshmërisë në deklarime, pasi nuk ka deklaruar sipas ligjit huan e marrë nga shtetasja I. F. si burim për shlyerjen e kredisë dhe as detyrimet financiare për shkak të saj.

**28.5.** Në përfundim të procesit, në konsideratë të kohës së largët të marrjes së kredisë dhe praktikës së përsëritur edhe në raste të subjekteve të tjera, sipas së cilës kontratat e shitjeve janë lidhur përpara disbursimit të kredisë dhe me qëllim vënien si garanci hipotekore të pasurisë objekt i tyre për shlyerjen e kredisë, Komisioni vlerësoi se kredia e marrë në vitin 2001 në shumën 12.000 USD është përdorur për blerjen e pasurisë apartament me sip. 70 m<sup>2</sup>, duke u konsideruar si burim i ligjshëm i përfitimit të saj. Për rrjedhojë, shuma 4.000.000 lekë, përfitur nga shitja e kësaj pasurie në datën 30.8.2005, u konsiderua si burim për blerjen e pasurisë objekt verifikimi, duke e reflektuar këtë fakt në analizën financiare të rishikuar.

#### ***Analizë e burimit “Kredi bankare në Raiffeisen Bank në vlerën 2.000.000 lekë, disbursuar në datën 19.8.2005”***

**29.** Në DPV-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar kredinë e marrë në muajin gusht 2005 në Raiffeisen Bank në vlerën 2.000.000 lekë dhe shumën e shlyer prej 178.000 lekësh, por nuk ka deklaruar qëllimin e kësaj kredie. Ndërsa në deklaratën *Vetting* e ka deklaruar këtë kredi si burim për blerjen e apartamentit objekt verifikimi dhe se kjo kredi është likuiduar në vitin 2007 me anë të një kredie të re të marrë në Raiffeisen Bank në vlerën 4.000.000 lekë, e deklaruar kjo si në DPV-në e vitit 2007 ashtu edhe në deklaratën *Vetting*, trajtuar më poshtë.

**29.1.** Sipas nxjerrjes së llogarisë së kredisë në Raiffeisen Bank në emër të z. Kujtim Bashaj figuron disbursim i kredisë në shumën 2.000.000 lekë, në datën 19.8.2005. Vlera prej 1.970.000 lekësh është tërhequr *cash* nga subjekti po në këtë datë. Po kështu, Raiffeisen Bank<sup>13</sup> ka konfirmuar se shtetasi Kujtim K. Bashaj ka marrë një kredi në datën 19.8.2005 në shumën 2.000.000 lekë, e cila është mbyllur në datën 30.3.2007 me marrjen e kredisë së re në shumën 4.000.000 lekë. Në lidhje me këto kredi banka deklaroi se nuk disponon dokumente, pasi dokumentet e kësaj periudhe janë asgjësuar bazuar në rregulloren e bankës pas plotësimit të afatit të ruajtjes (12 vjet), për llogaritur nga data e disbursimit të kredisë.

**29.2.** Përputhet deklarimi i subjektit për sa i takon shumën dhe datën e disbursimit të kredisë në vlerën 2.000.000 lekë e, si rrjedhojë, shuma prej 1.970.000 lekësh e tërhequr *cash* nga subjekti në datën 19.8.2005 është konsideruar në analizën financiare si e ardhur për pagesën e çmimit të apartamentit objekt verifikimi në datën 31.8.2005 kur është redaktuar deklarata noteriale. Sa i takon shlyerjes së kredisë, është vërtetuar shlyerja e saj nëpërmjet kredisë së marrë në vitin 2007.

#### ***Analizë e burimit “Hua në shumën 2.000.000 lekë, marrë shtetasit S. N.”***

**30.** Në lidhje me këtë hua u konstatua se:

<sup>13</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.11.2021, të Raiffeisen Bank në dosjen e Komisionit.

- Në DPV-në e vitit 2005 subjekti ka deklaruar një hua të marrë në muajin gusht 2005 në vlerën 2.000.000 lekë, por nuk ka deklaruar shkakun e marrjes së kësaj huaje.

- Në DPV-në e vitit 2006 ka deklaruar huan në vlerën 2.000.000 lekë, shumën e shlyer prej 1.000.000 lekësh pa ndonjë akt të shkruar dhe detyrimin e mbetur prej 1.000.000 lekësh.

- Në DPV-në e vitit 2007 ka deklaruar *paguar pjesa e mbetur e huas marrë në gusht 2005 (1.000.000 lekë)*. Të njëjtat shpjegime ka dhënë edhe në ILDKPKI në vitin 2016 në lidhje me këtë hua të marrë *cash*.

- Në deklaratën *Vetting* ka deklaruar hua në shumën 2.000.000 lekë, marrë shtetasit S. N. pa akt shkresor dhe pa interes, si dhe ka paraqitur deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.1.2017, sipas së cilës shtetasi S. N. N. deklaroi se në muajin gusht të vitit 2005 i ka dhënë borxh subjektit të rivlerësimit shumën 2.000.000 lekë pa interes dhe pa dokumente dhe se burimi i të ardhurave të kësaj shume ka qenë biznesi i tij në ndërtime. Kjo shumë i është shlyer me dy këste, ku kësti i fundit prej 1.000.000 lekësh i është kthyer në vitin 2007.

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të provuar të ardhurat e ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e shumës së dhënë hua prej 2.000.000 lekësh<sup>14</sup>. Komisioni kreu verifikime mbi mundësinë e huadhënësit S. N. për krijimin e shumës 2.000.000 lekë me të ardhura të ligjshme, si më poshtë:

- DRT Lezhë<sup>15</sup> ka konfirmuar se shtetasi S. N. N.: (i) figuron i regjistruar me NIPT \*\*\*, me datë 20.1.1997, duke përcjellë edhe xhirot e deklaruara për periudhën 1997 – 2016; (ii) figuron i regjistruar me NIPT \*\*\*, me datë 6.3.2008. Sipas shkresës, të dyja këto subjekte nuk kanë tërhequr dividend.

- QKB-ja<sup>16</sup> nuk ka konfirmuar të dhëna lidhur me subjektin “\*\*\*\*”.

- Nga verifikimi në faqen zyrtare të QKB-së, rezultoi: (i) personi fizik “\*\*\*\*” i regjistruar me NIPT \*\*\*, me datë regjistrimi 6.3.2008, me aktivitet “bar-restorant-hotel”; (ii) subjekti “\*\*\*\*” sh.p.k. me NIPT \*\*\* është regjistruar në datën 20.1.1997, ku ortak i vetëm dhe administrator i saj ka qenë S. N., deri në vitin 2021, kur aksionet i janë transferuar trashëgimtarëve të tij.

- Nga dokumentacioni i bashkëngjitur ekstraktit të shoqërisë gjeneruar nga QKB-ja, rezultoi se sipas vendimit të ortakut të vetëm të shoqërisë me nr. \*\*\*, datë 20.6.2005, është vendosur zmadhimi i kapitalit themeltar të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. nëpërmjet përfshirjes së fitimit të mbartur. Fitimeve të mbartura deri në vitin 2004 prej 3.641.022 lekësh i shtohet fitimi i vitit ushtrimor 2004 prej 705.735 lekësh, duke e rritur kapitalin themeltar me 4.346.757 lekë. Pra, fitimet e realizuara nga shoqëria deri në vitin 2004 janë riinvestuar në zmadhimin e kapitalit të shoqërisë e, si rrjedhojë, shoqëria nuk i ka shpërndarë dividend për këto vite ortakut të saj.

- Në përgjigje të kërkesës së Komisionit në lidhje me aktivitetin tregtar, S. N. N. me NIPT \*\*\* deri në vitin 2006, DRT Lezhë<sup>17</sup>, referuar të dhënave në arkivin e institucionit për të ardhurat dhe fitimin neto të realizuar për vitet 2001, 2005 dhe 2006, informon se për subjektin “\*\*\*\*” sh.p.k. me NIPT \*\*\*, subjekti ka realizuar fitim, por nuk ka informacion në lidhje me dividendin e tërhequr.

- ISSH dega e arkivit Tiranë<sup>18</sup> informon se mund të konfirmojnë të dhëna në lidhje me pagat e S. N. N. për periudhën 1994 – 2012 vetëm nëse jepen të dhëna në lidhje me emërtimin e

<sup>14</sup> Shihni aneksin nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>15</sup> Shihni aneksin nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>16</sup> Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 21.6.2023, të Qendrës Kombëtare të Biznesit në dosjen e Komisionit.

<sup>17</sup> Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 26.6.2023, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë në dosjen e Komisionit.

<sup>18</sup> Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 26.6.2022 (duhet të jetë lapsus viti) të ISSH degës së Arkivit të Rajonit Tiranë në dosjen e Komisionit.

qendrës së punës, NIPT etj. I është ridërguar shkresë këtij institucioni duke specifikuar edhe të dhëna të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., të cilët në kthim përgjigje<sup>19</sup> informojnë së nuk administrojnë dokumentacion në lidhje me këtë subjekt. I është dërguar shkresë DRSSH-së Lezhë në lidhje me të ardhurat nga paga për shtetasin S. N., mbi të cilat janë paguar kontributet, e cila në shkresën kthim përgjigjeje<sup>20</sup> konfirmon kontributet e derdhura për pagat e këtij shtetasi, por për periudhën pas vitit 2012.

- Iu kërkua subjektit të paraqesë dokumentacion për të provuar të ardhurat e ligjshme të huadhënësit S. N., i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2 paraqiti: (i) formularë deklarimi TVSH, TAP dhe kontribute sigurime shoqërore dhe shëndetësore për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. në periudhën 2004 – janar 2005; (ii) deklarime të shtetasit S. N. N. ndaj degës Tatim-Taksave Kurbin për periudhën 2004 – 2005 për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.a. Nga verifikimi i këtij dokumentacioni vihet re se: (i) shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. ka pasur aktivitet në këto vite, ku janë paguar edhe detyrimet tatimore sipas muajve, fakt që është evidentuar edhe nëpërmjet shkresave të përcjella nga DRT-ja (trajtuar më sipër); nga fitimet e realizuara ndër vite nga kjo shoqëri nuk ka tregues të përfitimit të të ardhurave nga ndarje dividendi, ndërsa për sa i përket të ardhurave nga paga deri në periudhën e dhënies së huas, nuk identifikohen sa kanë qenë; (ii) shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. duket se ka operuar në Laç me aktivitet lojëra fati (bingo), por nuk ka dokumentacion zyrtar të të dhënave financiare të kësaj shoqërie (pasqyra financiare etj.). Në mungesë të NIPT-it nuk mund të identifikohet dhe gjenerohet informacion në faqen zyrtare të QKB-së.

- Nga të dhënat bankare nuk identifikohen kanalizime pagash në favor të huadhënësit N. deri në periudhën kur është dhënë huaja. Po kështu nuk vërehen gjendje në llogaritë bankare personale apo të shoqërisë para dhënies së huas.

- Pas verifikimeve të kryera<sup>21</sup> nuk rezultoi konflikt interesi me shtetasin S. N. N. apo përfshirje në veprimtari të krimin të organizuar.

**30.1.** Bazuar sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ nuk është provuar burimi i ligjshëm i të ardhurave të huadhënësit S. N. N. e, si rrjedhojë, huaja prej 2.000.000 lekësh, dhënë subjektit në gusht 2005, nuk është konsideruar si burim në analizën financiare.

**31.** Sa i takon kthimit të huas shtetasit S. N. N., subjekti ka deklaruar në DPV-në e vitit 2006 pagimin e një kësti në shumën 1.000.000 lekë, por pa deklaruar burimin, ndërsa në DPV-në e vitit 2007 dhe në deklaratën *Vetting* ka deklaruar pagimin e këstit të mbetur të huas prej 1.000.000 lekësh me anë të kredisë së marrë në Raiffeisen Bank në vlerën 4.000.000 lekë, trajtuar më poshtë:

- I pyetur në lidhje me kohën e saktë të shlyerjes së detyrimit në shumën 1.000.000 lekë në vitin 2006, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti sqaron se kjo shumë i është dhënë huadhënësit në fund të vitit 2006, pa mundur të verifikojë datën ekzakte, pasi huadhënësi nuk jeton më. Për sa i përket burimit të të ardhurave për shlyerjen e kësaj shume, subjekti deklaroi se kanë shërbyer të ardhurat nga pagat e tij dhe bashkëshortes, si dhe të ardhurat nga shitja e një mjeti në shumën 250.000 lekë dhe ka depozituar kontratën e shitjes së tij me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\*kol., datë 16.9.2006. Shitja e këtij mjeti në shumën 250.000 lekë është deklaruar edhe në DPV-në e vitit 2006 nga ana e subjektit. Ky mjet është blerë nga bashkëshortja e subjektit në vitin 2003, deklaruar edhe në DPV-në e vitit 2003 në shumën 300.000 lekë, me burim të ardhura nga pagat e saj. Subjekti ka paraqitur dokumente të përfitimit të këtij mjeti: (i) kontratë shitjeje të mjetit në shumën 1.200 euro, në datën 11.9.2003, në gjuhën gjermane me përkthim

<sup>19</sup> Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 20.7.2023, të ISSH degës së Arkivit të Rajonit Tiranë në dosjen e Komisionit.

<sup>20</sup> Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 7.9.2023, të DRSSH Lezhë në dosjen e Komisionit.

<sup>21</sup> Shihni shkresat: nr. \*\*\* prot., datë 27.6.2023, të PGJSHPP Dibër; nr. \*\*\* prot., datë 26.6.2023 të PGJSHPP Shkodër; nr. \*\*\* prot., datë 6.7.2023, të PGJSHPP Lezhë; nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2023, të PGJSHPP Durrës; nr. \*\*\* prot., datë 4.7.2023, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

të noterizuar në datën 2.10.2003; (ii) akt zhdoganimi i mjetit datë 1.10.2003, ku cilësohet çmimi i blerjes prej 1.200 euro dhe shpenzime doganimi prej 158.271 lekësh. Nga analiza financiare duket se subjekti ka pasur mundësi për blerjen e mjetit të tij në vitin 2003 me të ardhurat nga pagat e bashkëshortes.

**31.1.** Nga ana e Komisionit u krye analiza financiare si në tabelën me poshtë për vitin 2006 për të verifikuar të ardhurat e ligjshme që kanë shërbyer për shlyerjen pjesore prej 1.000.000 lekësh të huas, marrë shtetasit S. N. Në këtë analizë janë konsideruar: (i) të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes së tij; (ii) të ardhurat e përfituara nga shitja e mjetit sipas kontratës së shitjes datë 16.9.2006; (iii) shpenzimet jetike sipas standardit të ILDKPKI-së sipas përbërjes familjare, si dhe shpenzime të tjera; (iv) likuiditetet e evidentuara në sistemin bankar dhe gjendjen *cash* të deklaruar nga ana e subjektit në deklaratat periodike.

Përshkrimi	2006
<b>Pasuritë</b>	<b>586,523</b>
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>	586,523
Gjendja e likuiditeteve (bankë + <i>cash</i> )	1,067,098
<b>Të ardhurat</b>	<b>1,810,685</b>
Paga subjekti	1,086,176
Paga bashkëshortja e subjektit	471,931
Të ardhura nga shitja e mjetit tip “Mercedes-Benz” (DPV 2006)	250,000
Të ardhura nga interesa bankare	2,578
<b>Shpenzimet</b>	<b>2,355,582</b>
Shpenzimet jetike	438,228
Shpenzime pagesë kredie në Raiffeisen Bank (interes + principal)	533,867
Shpenzime komisione bankare (kom. mirëmbajtje, interes ovd)	3,276
Shlyerje pjesore hua S. N.	1,000,000
Shpenzime udhëtimi në vendin e punës	78,443
Shpenzime TIMS	301,768
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>- 1,131,420</b>

**31.2.** Siç vërehet, subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për shlyerjen pjesore në shumën 1.000.000 lekë shtetasit S. N. në vitin 2006, për shkak të një balance negative prej 1.131.420 lekësh.

**32.** Në përfundim të hetimit administrativ, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve, ku duket se: (i) nuk është provuar burimi i ligjshëm i të ardhurave të huadhënësit S. N. N. për dhënien e huas prej 2.000.000 lekësh në gusht 2005; (ii) nuk vërtetohet shlyerja pjesore e huas në vlerën 1.000.000 lekë shtetasit S. N. në vitin 2006, për shkak të një balance negative prej 1.131.420 lekësh.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit**

**32.1.** Në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit S. N. N. për dhënien e huas prej 2.000.000 lekësh në vitin 2005, pretendohet se pavarësisht se nuk është mundur të sigurohet informacion në lidhje me të ardhurat nga paga e huadhënësit, si dhe faktit që njëra prej shoqërive ku ai ishte ortak/administrator nuk ka shpërndarë dividend ndër vite, në kushtet kur konflikti i interesit është i përjashtuar, si dhe shpërndarja e dividendit është përgjegjësi e administratorit, të ardhurat e disponuara nga huadhënësi duhet të konsiderohen si të ligjshme nga ana e Komisionit dhe të shërbejnë si burim për dhënien e huas. Subjekti nuk ka paraqitur asnjë provë të re shkresore.

**32.2.** Në përfundim të procesit, në kushtet kur: (i) nuk u vërtetua marrja e huas nëpërmjet një akti shkresor në kohë reale; (ii) nuk u vërtetua shpërndarje dividendi nga aktiviteti tregtar i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., ndërkohë që nga të dhënat bankare nuk vërehen llogari bankare/transaksione si në emër të shoqërisë ashtu edhe në emër të administratorit të saj (të dhëna të tilla figurojnë vetëm për periudhën pas vitit 2005 e në vijim); (iii) për shlyerjen pjesore të huas subjekti ka marrë dhe ka përdorur një kredi në vitin 2007, një veprim ky jo vetëm i



pajustificuar financiarisht (pasi huaja ka qenë pa interes ndërsa kredia me interes), por edhe i përsëritur nga ana e subjektit, Komisioni vlerësoi që subjekti nuk ka vërtetuar të kundërtën e barrës së provës sipas nenit 32/3 të ligjit nr. 84/2016 në lidhje me huan e marrë nga shtetasi S. N. Për rrjedhojë, huaja nuk është konsideruar si burim i ligjshëm për blerjen e pasurisë objekt verifikimi.

**32.3.** Subjekti, në parashtrime, nuk ka dhënë sqarime në lidhje me pamundësinë e kthimit pjesor të huas në vitin 2006 me të ardhura të ligjshme, konkretisht të shumës 1.000.000 lekë. Megjithatë, shuma e deklaruar e shlyerjes së huas prej 1.000.000 lekësh në vitin 2006, në përfundim të procesit u vlerësua të mos konsiderohet si shpenzim i subjektit, për sa kohë huaja e marrë nga S. N. nuk u konsiderua si burim për blerjen e pasurisë objekt verifikimi. Ky fakt është pasqyruar në analizën financiare të rishikuar të vitit 2006.

***Analizë e burimit “Kredi e marrë në datën 23.3.2007, në Raiffeisen Bank në shumën 4.000.000 lekë”, e cila ka shërbyer për shlyerjen e kështit prej 1.000.000 lekësh në vitin 2007 ndaj huadhënësit S. N. N. (si dhe për shlyerjen e kredisë së marrë në vitin 2005)***

### **33. Nga hetimi administrativ rezulton se:**

- Subjekti ka paraqitur së bashku me deklaratën *Vetting* fotokopje të kontratës së kredisë hipotekore datë 23.3.2007, sipas së cilës z. Kujtim K. Bashaj, i datëlindjes 31.10.1961, dhe znj. S. B. kanë marrë një kredi në Raiffeisen Bank në shumën 4.000.000 lekë, me objekt blerje shtëpie, duke lënë si kolateral apartamentin objekt verifikimi, paguar në vitin 2005.

- Në DPV-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar kredinë e marrë në mars 2007 në Raiffeisen Bank në shumën 4.000.000 lekë, me të cilën ka mbyllur kredinë e marrë në gusht të vitit 2005 dhe ka paguar pjesën e mbetur të huas së marrë në gusht 2005 prej 1.000.000 lekësh.

- Në DPV-të e viteve 2008 dhe 2009 subjekti ka deklaruar kredinë e marrë në vitin 2007 në shumën 4.000.000 për strehim.

- Në DPV-në e vitit 2010 ka deklaruar kredinë e marrë në vitin 2007 në shumën 4.000.000 për strehim, shlyerjen pjesore të saj në shumën 2.549.655 lekë nga të cilat shuma prej 2.195.000 lekësh është shlyer nga huaja e marrë (pa përcaktuar huamarrësin të cilin e ka deklaruar te të dhënat konfidenciale shtetasin N. Ll.), pjesa tjetër nga pagat.

- Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar kredinë e marrë në vitin 2007 në Raiffeisen Bank në shumën 4.000.000 lekë, si dhe huan e marrë nga shtetasi N. Ll. në shumën 2.500.000 lekë që ka shërbyer për shlyerjen e saj.

- Raiffeisen Bank<sup>22</sup> ka konfirmuar se shtetasi Kujtim K. Bashaj ka marrë një kredi në datën 30.3.2007 në shumën 4.000.000 lekë, e cila është mbyllur në datën 16.5.2016 me marrjen e një kredisë të re në shumën 1.500.000 lekë në këtë datë. Kredia e marrë në vitin 2016 është deklaruar në deklaratën *Vetting* nga subjekti (trajtuar në “Detyrimet financiare”).

- Sipas kontratës së kredisë bankare dhe hipotekës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.3.2007<sup>23</sup>, qëllimi i financimit është “blerje shtëpie”. Kredia e disbursuar në datën 30.3.2007 ka shërbyer për mbylljen e balancës së mbetur të kredisë së marrë në datën 19.8.2005 nga subjekti dhe bashkëshortja e tij.

- Sipas ekstraktit bankar të llogarisë nr. \*\*\* në emër të subjektit, në datën 30.3.2007 është disbursuar shuma 4.000.000 lekë, nga e cila, sipas përshkrimeve të veprimeve, shuma 1.512.097 lekë është transferuar për pagesë principali dhe interesa të kredisë, marrë në vitin 2005, ndërsa shuma 2.386.768 lekë është tërhequr *cash* nga subjekti në datën 11.4.2007. Nga kjo shumë, subjekti ka përdorur 1.000.000 lekë për kthim huaje shtetasit S. N. Siç vërehet, mbetet i paqartë destinacioni i shumës 1.386.768 lekë. Subjekti iu kërkua të japë informacion

<sup>22</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.11.2021, të Raiffeisen Bank në dosjen e Komisionit.

<sup>23</sup> Shihni dokumentacionin në aneksin nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

bazuar në dokumente shkresore për destinacionin e përdorimit të kësaj shume. Në lidhje me këtë kërkesë subjekti sqaron se nëpërmjet kësaj shume janë kryer shpenzime në lidhje me përgatitjen e vazjës për shkollim (kurse profesionale etj.) për të cilat deklarohet se asnjë nga këto shpenzime në vetvete nuk ka qenë një vlerë për t'u pasqyruar si shpenzim i deklarueshëm. Në këto kushte, shuma 1.386.768 lekë është përfshirë në analizën financiare të rishikuar në përfundim të procesit si shpenzim në vitin 2007 (kjo shumë nuk ishte konsideruar si e tillë në analizën fillestare).

***Analizë e burimit “Hua në shumën 2.500.000 lekë, marrë në vitin 2010 nga shtetasit N. Ll.”, e cila ka shërbyer për shlyerjen pjesore të kredisë së marrë në vitin 2007***

**34.** Nga hetimi administrativ rezulton se:

- Në DPV-në e vitit 2010 subjekti ka deklaruar huan prej 2.500.000 lekësh të marrë nga shtetasi N. D. Ll. me datë 23.4.2010, për shlyerjen e kredisë tek Raiffeisen Bank.

- Në deklaratën *Vetting* dhe pyetësorin standard, subjekti ka paraqitur një fotokopje deklarate me shkrim dore e datës 23.4.2010 të shtetasit N. D. Ll., në cilësinë e administratorit të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., i cili deklaron se i ka dhënë borxh z. Kujtim Bashaj shumën 2.500.000 lekë pa interes me të drejtë kthimi 10 vjet, me synim për të likuiduar kredinë, para të cilat i ka tërhequr nga llogaria e tij personale të siguruar nga paga e tij prej 500.000 lekësh në muaj. Kjo deklaratë nuk është përmendur në DPV-në e vitit 2010, fakt që ngre dyshime se deklarata e datës 23.4.2010 mund të jetë përpiluar për efekt të procesit të vettingut. Në vitin 2017 shtetasi N. D. Ll. ka bërë një deklaratë noteriale ku konfirmon dhënien e huas.

- Është raportuar transaksioni bankar me datë 23.4.2010 në vlerën 2.826.000 lekë pranë institucionit kompetent, me përshkrimin “Derdhje në llogari shlyerje kredie”.

**35.** Sa i takon të ardhurave nga paga të shtetasit N. Ll. për dhënien e huas 2.500.000 lekë në vitin 2010, u kryen verifikimet si vijojnë:

- U kërkua informacion nga bankat në lidhje me llogaritë e shtetasit N. D. Ll.<sup>24</sup> dhe nga të dhënat bankare evidentohet se nëpërmjet llogarisë bankare me nr. \*\*\* pranë Union Bank, në datën 9.4.2010 janë kanalizuar pagat e shtetasit N. D. Ll. nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në total shuma 881.946 lekë, të cilat janë tërhequr në vijim pas datës 30.4.2010, ndërsa në llogarinë nr. \*\*\* të tij në Raiffeisen Bank është kanalizuar pagë në shumën 15.184 lekë në datën 13.4.2010. Para kësaj periudhe (prill 2010) nuk identifikohen kanalizime pagash nëpërmjet sistemit bankar për shtetasin N. Ll.

- Është kërkuar informacion në DRSSH Lezhë<sup>25</sup> mbi të ardhurat bruto dhe neto të realizuara nga shtetasi N. Ll., e cila konfirmon se ky shtetas rezulton i siguruar dhe janë derdhur kontributet mbi bazën e pagës bruto, por informacioni sipas sistemit CIMS gjenerohet vetëm për pagat pas vitit 2012.

Sa më sipër, nuk vërtetohen tërheqje të pagave para momentit të dhënies së huas në prill 2010, kur është dhënë huaja. Edhe dy pagat që janë vërtetuar si më sipër, janë tërhequr pasi është dhënë huaja.

- Pas verifikimeve të kryera<sup>26</sup> nuk rezultoi konflikt interesi me shtetasin N. Ll. dhe shoqëritë “\*\*\*\*” sh.p.k., “\*\*\*\*” sh.p.k., “\*\*\*\*” sh.p.k., “\*\*\*\*” sh.p.k., “\*\*\*\*” sh.p.k., “\*\*\*\*” sh.p.k. apo përfshirje në veprimtari të krimit të organizuar.

<sup>24</sup> Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 5.7.2023, të Union Bank sh.a. dhe nr. \*\*\* prot., datë 18.7.2023 të Raiffeisen Bank në dosjen e Komisionit.

<sup>25</sup> Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 27.6.2023, të DRSSH Lezhë, në dosjen e Komisionit.

<sup>26</sup> Shihni shkresat: nr. \*\*\* prot., datë 27.6.2023, të PGJSHJP Dibër; nr. \*\*\* prot., datë 26.6.2023, të PGJSHJP Shkodër; nr. \*\*\* prot., datë 6.7.2023, të PGJSHJP Lezhë; nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2023, të PGJSHJP Durrës; nr. \*\*\* prot., datë 4.7.2023, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

**36.** Pavarësisht sa më sipër, është konstatuar se në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka paraqitur një deklaratë të re noteriale datë 23.1.2017 (fotokopje) të shtetasit N. D. Ll. në cilësinë e administratorit të shoqërive “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh.p.k., i cili deklaron dhënien e huas subjektit në vitin 2010 dhe likuidimin total në vitin 2016, por nuk është shprehur për burimin e të ardhurave të huas. Bashkëlidhur përgjigjeve, subjekti ka paraqitur nxjerrje llogarie bankare të subjekteve “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh.p.k. për vitin 2010 pranë Raiffeisen Bank, ku identifikohen veprime me natyrë biznesi. Pavarësisht se shtetasi N. Ll. në deklaratën e tij të datës 23.4.2010 ka deklaruar se fondet për dhënien e huas i ka tërhequr nga llogaria e tij personale e pagës prej 500.000 lekësh në muaj, pa përmendur të ardhura nga ndonjë biznes privat dhe, për një hetim sa më shterues, Komisioni verifikoi të dhënat në lidhje me aktivitetin e dy shoqërive tregtare “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh.p.k., nga ku ka rezultuar se:

### **36.1. Sa i takon shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.**

- DPT<sup>27</sup> konfirmon se shtetasi N. D. Ll. rezulton administrator i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me NIPT \*\*\*, regjistruar në QKB në datën 16.2.2007. Shoqëria ka deklaruar të ardhura dhe fitim për vitet 2009 – 2010, por pa shpërndarë dividend. Në këto shkresa konfirmohet se ky shtetas është i lidhur edhe me shoqëri të tjera në cilësinë e administratorit, me datë regjistrimi pas datës së dhënies së huas subjektit të rivlerësimit (23.4.2010).

- Në ekstraktin bankar të llogarisë nr. \*\*\* të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. në Union Bank sh.a. të paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2, pasqyrohet transaksioni i datës 9.4.2010, tërheqje në shumën 4.000.000 lekë nga shtetasi N. Ll., nga e cila, sipas subjektit, atij i është dhënë huaja prej 2.500.000 lekësh. Kjo shumë e tërhequr nga shtetasi N. Ll. nuk mund të konsiderohet si burim për dhënien e huas pasi ajo është tërhequr nga një llogari biznesi dhe nuk mund të identifikohet destinacioni i përdorimit të saj. Për më tepër, huaja prej 2.500.000 lekësh, e dhënë duke u tërhequr *cash* nga fondet e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., sikurse subjekti pretendon, nuk është deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin 2010 dhe as likuidimi i saj në vitet në vijim.

### **36.2. Sa i takon shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.**

Në shkresat e DPT-së nuk ka informacion në lidhje me këtë shoqëri, por nga ekstrakti i biznesit, gjeneruar nga faqja zyrtare e Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se shtetasi N. Ll. është administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me NIPT \*\*\*, regjistruar në datën 1.7.1996 dhe aktualisht me status “çregjistruar pa likuidim”.

DRT Lezhë<sup>28</sup> informon se sipas pasqyrave financiare të depozituara nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me NIPT \*\*\* për periudhën 2001 – 2010, shoqëria rezulton me fitim, por nuk ka informacion në lidhje me shpërndarje dividendi.

Nga verifikimet e bëra në dokumentacionin bashkëngjitur ekstraktit historik të shoqërisë, duket se shoqëria ka rezultuar me fitime në vitet 2007 – 2009 dhe sipas vendimeve të ortakut të vetëm, këto fitime janë kapitalizuar, pra nuk i janë shpërndarë ortakut, por janë përdorur për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë.

Bazuar në sa më sipër, nuk u vërtetuan të ardhura të përfituara nga shtetasi N. D. Ll. nga shoqëritë tregtare “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh.p.k. Po kështu, nuk është vërtetuar që në momentin e dhënies së huas 23.4.2010, shtetasi N. D. Ll. të ketë pasur gjendje në llogaritë personale bankare shumën 2.500.000 lekë me të ardhurat nga pagat, të cilat të kenë shërbyer për dhënien e huas në këtë shumë. Si rrjedhojë, në përfundim të hetimit administrativ huaja prej 2.500.000 lekësh marrë nga ky shtetas nuk është konsideruar si burim për shlyerjen pjesore të kredisë pranë Raiffeisen Bank në analizën financiare të vitit 2010.

<sup>27</sup> Shihni shkresat kthim përgjigjeje të DPT-së (Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë) nr. \*\*\* prot., datë 6.9.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 17.8.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>28</sup> Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 5.7.2023, të DRT Lezhë në dosjen e Komisionit.

37. Në këto kushte, Komisioni kreu analizën financiare për të verifikuar mundësinë e krijimit të depozitës prej 2.826.000 lekësh në datën 23.4.2010, në llogarinë e subjektit pranë Raiffeisen Bank, e cila ka shërbyer për shlyerje të kredisë (sipas përshkrimit të tij e përberë nga 2.500.000 lekë huaja e pretenduar nga N. Ll. + 326.000 lekë fonde të tij). Në tabelën si më poshtë, duket se subjekti nuk ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për krijimin e kësaj depozite për shkak të balancës negative në shumën 2.752.527 lekë.

Përshkrimi	1.1.2010 – 23.4.2010
<b>Pasuritë</b>	<b>2,663,987</b>
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>	2,863,987
Gjendja e likuiditeteve	2,836,226
<b>Detyrime</b>	<b>(28,331)</b>
Kredi bankare Raiffeisen Bank (disbursuar më 30.3.2007)	
<i>Pagesë principali</i>	-28,331
<b>Pasuri neto (pasuri - detyrime)</b>	<b>2,892,318.65</b>
<b>Të ardhurat</b>	<b>583,576</b>
Të ardhura nga paga subjekti	310,915
Të ardhura nga paga bashkëshortja	272,607
Të ardhura nga interesa bankare	54
<b>Shpenzimet</b>	<b>643,784</b>
Shpenzimet jetike	159,390
Shpenzime komisione bankare (kom. mirëmbajtjeje etj.)	375
Shpenzim pagese interesi kreditë në Raiffeisen Bank	136,022
Shpenzime udhëtimi në vendin e punës	19,213
Shpenzime udhëtimi TIMS	328,785
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>- 2,752,527</b>

38. Veç sa më sipër, duke qenë se subjekti ka kryer deklarime në lidhje me shlyerjen e huas ndaj shtetasit N. Ll., është verifikuar mundësia e shlyerjes së huas me të ardhura të ligjshme sipas vetëdeklarimeve të tij në deklaratat periodike të viteve 2011 – 2016<sup>29</sup>, nga ku duket se subjekti nuk ka pasur mundësi për të kursyer, mbuluar shpenzimet e tjera familjare dhe shlyer huan për periudhën 2011 – 2015 për shkak të rezultatit negativ të këtyre viteve (pasqyruar në tabelën përmbledhëse të analizës financiare në përfundim të hetimit administrativ).

39. Në përfundim të hetimit administrativ, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve, ku duket se: (i) nuk është provuar burimi i ligjshëm i të ardhurave të huadhënësit N. Ll. për dhënien e huas prej 2.500.000 lekësh më 23.4.2010; (ii) nuk vërtetohet shlyerja me të ardhura të ligjshme e huas së dhënë shtetasit N. Ll. gjatë periudhës 2011 – 2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit**

39.1. Subjekti kundërshton moskonsiderimin si të ligjshme të të ardhurave të shtetasit N. Ll., por, përveçse çfarë ka dokumentuar gjatë procesit të hetimit administrativ, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion shtesë për të ardhurat nga paga, dhe jo vetëm, për huadhënësin N. Ll.

39.2. Në përfundim të procesit nuk u vërtetuan të ardhura me burim paga të shtetasit Nikolin Lleshi për dhënien e huas sipas vetëdeklarimeve të tij në deklaratën e datës 23.4.2010 dhe as të ardhura të ligjshme në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës të të dyja shoqërive tregtare, ku ky shtetas ka ushtruar aktivitetet. Për më tepër, subjekti e ka marrë këtë hua për të shlyer pjesërisht kredinë e vitit 2007 dhe, për të shlyer pjesërisht huan nga ky shtetas ka marrë kredinë e vitit 2016, veprim ky i përsëritur në disa raste. Në këto kushte, Komisioni

<sup>29</sup> Në DPV-të e viteve 2011 dhe 2012 ka deklaruar se ka paguar shumat nga 400.000 lekë me burim kursime nga pagat, ndërsa në DPV-të e viteve 2013 dhe 2014 ka deklaruar se ka paguar shumat nga 500.000 lekë me kursime nga pagat. Në DPV-në e vitit 2015 ka deklaruar pagimin e shumës 400.000 lekë, ndërsa në DPV-në e vitit 2016 ka deklaruar pagimin e shumës 300.000 lekë.

vlerësoi se subjekti nuk ka vërtetuar të kundërtën e barrës së provës sipas nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016 në lidhje me huan e marrë nga shtetasi N. Ll. Për rrjedhojë, huaja e marrë nga ky shtetas nuk është konsideruar si burim krijimi i pasurisë objekt verifikimi në analizën financiare të rishikuar.

**39.3.** Sa i takon pamundësisë financiare për shlyerjen e huas, pavarësisht se pretendimet e subjektit në parashtrime nuk qëndrojnë, në përfundim të procesit shumat e deklaruara për shlyerjen e pretenduar të huas së marrë shtetasit N. Ll. në periudhën 2011 – 2016, në DPV-të e këtyre viteve nuk u konsideruan si shpenzime në analizën financiare të këtyre viteve, për sa kohë huaja nuk u konsiderua si burim për blerjen e pasurisë.

***Analizë e burimit “Kursimet e vitit paraardhës”, deklaruar si burim vetëm në përgjigje të pyetësorit standard***

**40.** Me nënshkrimin e deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.8.2005, subjekti ka paguar shumën 67.069 euro për blerjen e apartamentit objekt verifikimi, shumë e cila e konvertuar me kursin e kësaj date<sup>30</sup> përkon në 8.259.547 lekë. Në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si burim shumat: 4.000.000 lekë nga shitja e apartamentit; 2.000.000 lekë nga kredia; 2.000.000 lekë nga huaja shtetasit S. N., pra në total 8.000.000 lekë. Siç vërehet, burimi i deklaruar në deklaratën *Vetting* nuk mbulon çmimin e paguar më 31.8.2005 në vlerën 259.547 lekë. Për këtë arsye duket se subjekti, në përgjigje të pyetësorit standard, ka shtuar si burimin dhe kursimet e vitit paraardhës, pra kursimet e vitit 2004. I pyetur se sa ka qenë shuma e përdorur për blerjen e apartamentit me burim kursimet e vitit paraardhës, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti deklaroi se ka qenë shuma rreth 290.000 lekë.

**40.1** Për sa i takon kursimeve nga viti paraardhës, nga verifikimi i DPV-së së vitit 2004 vërehet se subjekti ka deklaruar kursime *cash* nga paga në shumën 500.000 lekë, si dhe nga aktet në dosje rezultoi se në datën 23.1.2004 subjekti ka depozituar në bankë shumën 9.904 USD që ka shërbyer për shlyerjen e kredisë së marrë në vitin 2001 pranë Bankës Amerikane (trajtuar më sipër). Gjithashtu, në DPV-në e vitit 2005 subjekti nuk ka deklaruar shtesë/pakësim të gjendjes *cash*. Nga ana e Komisionit është kryer analiza financiare e vitit 2004 për të vlerësuar mundësinë për kursime me burime të ligjshme të gjendjes *cash* prej 500.000 lekësh të deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2004, sipas tabelës që vijon:

Përshkrimi	2004
<b>Pasuritë</b>	<b>495,709</b>
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>	495,709
Gjendja e likuiditeteve (bankë + <i>cash</i> )	500,000
<b>Të ardhurat</b>	<b>1,491,644</b>
Paga subjekti	1,177,786
Paga bashkëshortja e subjektit	313,858
<b>Shpenzimet</b>	<b>1,841,595</b>
Shpenzimet jetike	375,856
Shpenzime shlyerje kredie (janar 2004)	1,054,307
Shpenzime komision për shlyerje para afatit të kredisë dhe komisione bankare	5,486
Shpenzime udhëtimi në vendin e punës	76,422
Shpenzime TIMS	329,524
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>- 845,660</b>

**40.2.** Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të kursyer shumën *cash* prej 500.000 lekësh të deklaruar në DPV-në e vitit 2004 për shkak të një balance negative prej 845.660 lekësh. Për rrjedhojë, shuma 290.000 lekë nuk është konsideruar si burim për blerjen e pasurisë objekt verifikimi.

<sup>30</sup> Kursi zyrtar i Bankës së Shqipërisë në datën 31.8.2005 është Eur/Lek = 123.15.

**40.3.** Në prapësimet e tij, subjekti sqaron se vlera 500.000 lekë *cash* është deklaruar gjendje në fund të vitit 2004. Në deklaratën e vitit 2005 nuk ka deklaruar kursime *cash*, që do të thotë se të ardhurat *cash* të vitit të kaluar janë harxhuar në këtë vit. Më tej, sipas subjektit, në fund të vitit 2004 është krijuar mundësia për këto kursime, pasi në fillim të këtij viti, kredia e marrë në vitin 2001 është shlyer me të ardhurat nga huaja e marrë nga shtetasja I. F. Subjekti ka paraqitur një analizë financiare për të vërtetuar mundësinë për kursime të gjendjes *cash* prej 500.000 lekësh në vitin 2004, duke përfshirë huan e marrë nga shtetasja I. F. në shumën 10.000 USD për shlyerjen e kredisë pranë Bankës Amerikane në janar 2004, pretendim i cili nuk u mor në konsideratë (trajtuar në paragrafin nr. 27.1).

**40.4.** Në përfundim të procesit u vlerësua se, subjekti nuk ka mundur të vërtetojë të kundërtën e konstatimit që i përket krijimit të kursimeve në shumën 500.000 lekë në vitin 2004, për shkak të moskonsiderimit të marrjes në konsideratë të huas nga shtetasja I. F. në muajin janar 2004. Për rrjedhojë, kursimet në shumën 290.000 lekë nuk janë konsideruar si e ardhur e ligjshme në analizën financiare të rishikuar.

#### **Analiza financiare për pagesën e çmimit të shitjes së apartamentit objekt verifikimi sipas deklaratës së datës 31.8.2005**

**41.** Në përfundim të analizimit të të gjitha burimeve të deklaruara nga subjekti si më sipër, është kryer analiza financiare në datën 31.8.2005 kur është nënshkruar deklarata noteriale për të vlerësuar mundësinë e kursimit me burime të ligjshme të subjektit dhe bashkëshortes së tij të shumës 67.069 euro/8.259.547 lekë. Në këtë analizë janë konsideruar: (i) të ardhurat nga pagat e subjektit dhe bashkëshortes së tij; (ii) kredia në shumën 2.000.000 lekë, disbursuar në Raiffeisen Bank datë 19.8.2005; (iii) shpenzimet sipas standardit të ILDKPKI-së sipas pjesëtarëve të familjes. Nuk janë konsideruar të ardhurat nga shitja e apartamentit të blerë në vitin 2001 dhe nga huaja marrë shtetasit S. N. (trajtuar më sipër).

Përshkrimi	1.1 – 31.8.2005
<b>Pasuritë</b>	<b>8,151,257</b>
Apartament me sip. 131 m <sup>2</sup> , Tiranë	8,259,547.35
Gjendja e likuiditeteve	(108,290)
<b>Detyrime</b>	<b>2,000,000</b>
Hua Raiffeisen Bank	2,000,000
Hua S.N.	0
<b>Pasuri neto</b>	<b>6,151,257</b>
<b>Të ardhurat</b>	<b>962,716</b>
Paga subjekti	746,265
Paga bashkëshortja e subjektit	216,451
Të ardhura nga shitja e apartamentit blerë në vitin 2001	0
<b>Shpenzimet</b>	<b>376,327</b>
Shpenzimet jetike	292,152
Shpenzime të kredisë (komision disbursimi RZB)	30,000
Shpenzime udhëtimi në vendin e punës	54,175
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>- 7,564,869</b>

Sa më sipër, nuk vërtetohen burime financiare të ligjshme për të paguar shumën 67.049 euro në datën 31.8.2005, për shkak të balancës negative prej 7.564.869 lekësh.

**42.** Në përfundim të hetimit administrativ në lidhje me pasurinë objekt verifikimi, rezultoi se:

- Subjekti nuk justifikon pagimin e çmimit të blerjes së pasurisë në vlerën 67.049 euro në datën 31.8.2005 me të ardhura të ligjshme, për shkak të balancës negative prej 7.564.869 lekësh.

- Nuk justifikohet ulja e çmimit të blerjes së pasurisë nga 67.069 euro në 52.440 euro, fakt i cili nuk gjen pasqyrim në asnjë prej DPV-ve dhe deklaratimet e subjektit gjatë hetimit administrativ në lidhje me këtë ulje, duket se janë kryer për efekt të justifikimit të blerjes së

garazheve brenda vlerës 67.069 euro, duke e vënë atë në kushtet e deklarimit të pasaktë të çmimit të shitjes së pasurisë në kontratën e shitjes së vitit 2007 dhe në deklaratën *Vetting*.

- Subjekti nuk ka kryer deklarime të sakta në lidhje me burimet që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë, si dhe për shlyerjet e detyrimeve të kredive apo huave që ka marrë me qëllim blerjen e pasurisë. Për më tepër, subjekti në mënyrë të përsëritur ka marrë kredi për shlyerjen e huave dhe hua për shlyerjen e kredive, për shlyerjen e të cilave nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme.

Për rrjedhojë, duket se subjekti nuk ka plotësuar kriteret e parashikuara në pikat 1 dhe 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar në shkronjat "a" dhe "b" të nenit 33 të ligjit ka kryer deklarime të pasakta e të pamjaftueshme në lidhje me këtë pasuri. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e këtyre konstatimeve.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit**

**42.1.** Në parashtrimet e tij në lidhje me barrën e provës për pikat si më sipër, subjekti ka paraqitur të njëjtat shpjegime dhe dokumentacione si gjatë procesit të hetimit administrativ, duke sqaruar se:

- Balanca negative e analizës financiare të kryer nga Komisioni është rrjedhojë e moskonsiderimit nga ana e Komisionit e burimeve si vijojnë: (i) kredisë së marrë për blerjen e apartamentit me sip. 70 m<sup>2</sup> në vitin 2001, duke e penalizuar dyfish subjektin, pasi si rrjedhojë, nuk janë konsideruar si të ligjshme të ardhurat e përfituara nga shitja e tij në vitin 2005 në shumën 4.000.000 lekë; (ii) huas së marrë nga shtetasja I. F. për shlyerjen e kredisë në vitin 2004, si rrjedhojë, gjendja *cash* e deklaruar si kursim në vitin 2005 nuk është konsideruar si burim; (iii) huas së marrë nga shtetasi S. N. në vitin 2005 në shumën 2.000.000 lekë, si një nga burimet për blerjen e apartamentit objekt verifikimi.

Në lidhje me analizën financiare, në përfundim të procesit, pasi janë analizuar në mënyrë analitike të gjitha burimet e deklaruara të pasurisë, Komisioni vlerësoi të konsiderojë shumën 4.000.000 lekë të përfituar nga shitja e pasurisë me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.8.2005, ndërsa konstatimet në lidhje me burimet e tjera të mbeten të pandryshuara. Nga rishikimi i analizës financiare, balanca negative nga -7.564.869 lekë bëhet në -2.259.547 lekë.

- Subjekti shpjegon, ashtu si edhe në përgjigjen e pyetësorit nr. 2 dhe konfirmuar edhe në deklaratën e shtetasit Xh. H. (shitësit), se çmimi i parë i blerjes së apartamentit në deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.8.2005, ka qenë ai i paramenduari për shitje, jo definitiv. Sipas subjektit, çmimi i shitjes është ai i deklaruar në kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.1.2007, në shumën 52.440 euro. Ndërsa, për sa i përket ndryshimit të sipërfaqes së apartamentit nga 142.7 m<sup>2</sup> në 131.1 m<sup>2</sup>, e për rrjedhojë edhe të çmimit të pasurisë, subjekti ka parashtruar të njëjtat pretendime si edhe gjatë hetimit administrativ, të cilat edhe në përfundim të procesit nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni referuar fakteve e rrethanave të trajtuara e arsyetuara hollësisht në paragrafin 21 të këtij vendimi.

- Në lidhje me pasaktësitë në deklarimin e burimeve të krijimit të pasurisë dhe faktit që në mënyrë të përsëritur ka marrë kredi për shlyerjen e huave dhe hua për shlyerjen e kredive, për shlyerjen e të cilave nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme, subjekti nuk ka dhënë sqarime, fakt i mbajur në konsideratë gjatë procesit të vendimarrjes.

**42.2.** Bazuar në sa më sipër, subjekti nuk ka vërtetuar të kundërtën e barrës së provës në lidhje me pasurinë objekt verifikimi, pasi nuk ka plotësuar kriteret e parashikuara në pikat 1 dhe 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar në shkronjat "a" dhe "b" të nenit 33 të ligjit ka kryer deklarime të pasakta e të pamjaftueshme në lidhje me këtë pasuri.

**43. Garazh me sip. 27.3 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\* , në rrugën "\*\*\*\*" (\*\*\*)**, me nr. pasurie \*\*\*, blerë me kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme (garazh) nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.1.2007, në vlerën 5.460 euro, në bashkëpronësi të familjes, në pjesë të barabartë.

**44. Garazh me sip. 10.1 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, në rrugën “\*\*\*\*” (\*\*\*)**, me nr. pasurie \*\*\*, blerë me kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme (garazh) nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.3.2008, në vlerën 2.028 euro, në bashkëpronësi të familjes.

**45. Duke qenë se për të dyja garazhet subjekti ka deklaruar se nuk është paguar çmim për shkak të uljes së çmimit të apartamentit me sip. 131 m<sup>2</sup>, pretendim i cili nuk është marrë në konsideratë sikurse është arsyetuar në paragrafin 21, Komisioni ka përmbledhur hetimin për të dyja pasuritë garazh, si vijon:**

**45.1. Në lidhje me origjinën dhe mënyrën e fitimit të pronësisë nga aktet në dosje<sup>31</sup>, rezulton se:**

- Me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\*kol., datë 8.1.2007, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. i shet shtetasit Kujtim Basha një garazh me sip. 27.3 m<sup>2</sup>, regjistruar në regj. hip. \*\*\*, datë 8.9.2006, në rrugën “\*\*\*\*”, në çmimin 5.460 euro, likuiduar totalisht jashtë zyrës, i regjistruar më pas në pronësi të shtetasit Kujtim Basha, sipas vërtetimit hipotekor nr. \*\*\*, datë 1.2.2007. Në DPV-në e vitit 2006, dorëzuar në datën 27.3.2007, ka deklaruar blerjen e garazhit në vlerën 5.460 euro dhe pjesën takuese 50%, por pa deklaruar burimin.

- Me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.3.2008, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. i shet shtetasit Kujtim Basha një garazh me sip. 10.1 m<sup>2</sup>, regjistruar në regj. hip. \*\*\*, datë 8.9.2006, në rrugën “\*\*\*\*”, në çmimin 2.028 euro, likuiduar totalisht jashtë zyrës, i regjistruar më pas në pronësi të shtetasit Kujtim Basha, sipas vërtetimit hipotekor nr. \*\*\*, datë 11.4.2008. Në DPV-në e vitit 2008 subjekti ka deklaruar blerjen e garazhit me sip. 10.14 m<sup>2</sup> në vlerën 2.028 euro, me burim kursimet.

- ZVRPP Tiranë dhe ASHK<sup>32</sup> Drejtoria Vendore Tirana Veri nuk kanë konfirmuar pasuri në emër të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur me të. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti paraqiti shkresën datë 26.1.2017 të ZVRPP-së, me të cilën në vërtetohet regjistrimi emrin e tij, përkatësisht të garazheve nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, si dhe të apartamentit nr. \*\*\* (trajtuar më sipër), duke përcjellë edhe kartelat përkatëse etj. Me kërkesë të Komisionit ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri, me shkresën datë 8.9.2023, ka konfirmuar në pronësi të shtetasit Kujtim Kadri Basha vetëm garazhin nr. \*\*\*.

Sa më sipër, nuk konstatohen problematika në lidhje me origjinën dhe fitimin e pronësisë së dy pasurive garazh.

**45.2. Sa i takon trajtimin të mundshëm preferencial në blerjen e këtyre pasurive**, bazuar në udhëzimin nr. 9, datë 26.2.2008 “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”<sup>33</sup>, çmimi për metër katror sipërfaqe garazhi është 70% e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas zonave. Referuar çmimeve minimale për efekt fiskal (lekë/m<sup>2</sup>) sipas udhëzimeve respektive të viteve 2007 dhe 2008 të EKB-së për qytetin e Tiranës, në të dyja rastet rezulton se garazhet janë blerë më lirë, përkatësisht 1.853.670 lekë/15.330,98 euro dhe 834.015 lekë/6.770,70 euro. Iu kërkuar të paraqesë kontrata të ngjashme, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2 paraqiti dy kontrata për blerje garazhesh në vitin 2007 dhe një në vitin 2009 në të njëjtin objekt, ku nga krahasimi me çmimet e garazheve objekt verifikimi, çmimet e tyre të blera në vitin 2007 janë të njëjta (200 euro/m<sup>2</sup>), ndërsa garazhi i blerë në vitin 2009 është më i shtrenjtë (400 euro/m<sup>2</sup>).

**45.3. Në lidhje me burimin e krijimit rezulton se:**

- Në DPV-në e vitit 2006, subjekti nuk e ka deklaruar burimin e garazhit të parë. Në DPV-në e vitit 2008 për blerjen e garazhit të dytë ka deklaruar si burim kursime familjare, deklarim i

<sup>31</sup> Shihni aneksin nr. \*\*\* dhe aneksin nr. \*\*\* në dosjen ILDKPKI.

<sup>32</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.3.2021, të ASHK DVTV, në dosjen e Komisionit.

<sup>33</sup> Para këtij viti (2008) nuk ka pasur udhëzim, ndaj merret në konsideratë përqindja e cilësuar në këtë udhëzim edhe për vitin 2007.



cili bie në kundërshtim me deklarin në deklaratën *Vetting*, ku subjekti ka deklaruar si burime krijimi për garazhet të njëjtat burime si për apartamentin me sip. 131.1 m<sup>2</sup>, trajtuar më lart.

- Në përgjigje të pyetësorit standard dhe atij nr. 2, subjekti ka shpjeguar se për blerjen e apartamentit me sip. 131.1 m<sup>2</sup> në datën 8.1.2007 palët kanë negociuar për uljen e çmimit nga ai i paguar në vitin 2005 prej 67.069 euro, në çmimin 52.440 euro dhe me diferencën prej 14.629 euro janë paguar garazhet e blera në të njëjtën ndërtesë. Ndërkohë, në asnjë prej kontratave të blerjes së garazheve nuk rezulton të jetë përshkruar mënyra e pagimit të çmimit të blerjes së tyre sipas deklarimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ.

Sikurse është trajtuar më sipër, pretendimet e subjektit për përfshirjen e çmimit të blerjes së garazheve në shumën 67.069 euro, paguar në vitin 2005 për blerjen e apartamentit me sip. 131.1 m<sup>2</sup>, nuk janë marrë në konsideratë. Në këto kushte, nga ana e Komisionit u krye analiza financiare për të vlerësuar mundësinë për kursim të subjektit dhe bashkëshortes së tij për blerjen e garazheve, përkatësisht në datën 8.1.2007 në çmimin 5.460 euro dhe në datën 4.3.2008 në çmimin 2.028 euro, sipas tabelës përmbledhëse si më poshtë:

<b>Përshkrimi</b>	<b>1.1.2007 – 8.1.2007</b>	<b>1.1.2008 – 4.3.2008</b>
<b>Pasuritë</b>	<b>582,914</b>	<b>153,234</b>
Garazhe	677,914	253,094
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>	<i>-95,000</i>	<i>(99,860)</i>
Gjendja e likuiditeteve	972,098	1,104,847
<b>Detyrime</b>	<b>-</b>	<b>(14,334)</b>
Hua Raiffeisen Bank	-	(14,334)
<b>Pasuri neto</b>	<b>582,914</b>	<b>167,568</b>
<b>Të ardhurat</b>	<b>-*</b>	<b>370,065</b>
Paga subjekti	-	277,530
Paga bashkëshortja e subjektit	-	92,535
<b>Shpenzimet</b>	<b>14,717</b>	<b>290,401</b>
Shpenzimet jetike	11,978	91,080
Shpenzime udhëtimi në vendin e punës	2,739	11,658
Shpenzime pagese kredie (interes)	-	59,018
Shpenzime TIMS	-	128,645
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>- 597,630</b>	<b>-87,904</b>

\*Pagat e para për vitin 2007 janë kredituar në llogaritë bankare respektivisht për subjektin në datën 2.2.2007 dhe bashkëshorten në datën 9.1.2007, pra pas datës së blerjes së garazhit.

Siç vërehet, duket se subjekti dhe bashkëshortja nuk kanë pasur mundësi financiare për të kursyer dhe blerë garazhet në datat 8.1.2007 dhe 4.3.2008, si dhe mbuluar shpenzimet e tjera familjare, për shkak të rezultatit negativ, përkatësisht në vlerat 597.630 lekë dhe 87.904 lekë. Edhe në rastin që do të merreshin në konsideratë pretendimet e subjektit dhe çmimi për blerjen e garazheve do të konsiderohej i paguar që në vitin 2005, duke qenë pjesë përbërëse e shumës 67.069 euro, nga analiza financiare e kryer në përfundim të hetimit administrativ duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për të paguar këtë shumë në vitin 2005 (trajtuar hollësisht në analizën financiare të pasurisë apartament, përshkruar në paragrafin 18).

**45.4.** Në përfundim të hetimit administrativ në lidhje me pasuritë garazhe, rezultoi se:

- Subjekti nuk ka justifikuar blerjen e garazheve me të ardhura të ligjshme për shkak të balancave respektive për secilin garazh, përkatësisht -597.630 lekë dhe -87.904 lekë.

- Subjekti nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë burimin e krijimit të garazheve, pasi: (i) në DPV-në e vitit 2006 subjekti nuk e ka deklaruar burimin e garazhit të parë; (ii) në DPV-në e vitit 2008 për blerjen e garazhit të dytë ka deklaruar si burim kursime familjare, deklarim i cili bie në kundërshtim me deklarin në deklaratën *Vetting*, ku subjekti ka deklaruar si burime krijimi për garazhet të njëjtat burime si për apartamentin me sip. 131.1 m<sup>2</sup>; (iii) gjatë hetimit ka deklaruar se për blerjen e garazheve nuk janë paguar lekë për shkak të zbritjes së çmimit të

blerjes së pasurisë apartament, fakt i cili nuk rezulton të jetë bërë prezent në asnjë prej DPV-ve dhe as në deklaratën *Vetting*.

Për rrjedhojë, duket se subjekti nuk ka plotësuar kriteret e parashikuara në pikën 1 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar në shkronjat “a” dhe “b” të nenit 33 të ligjit ka kryer deklarime të pasakta e të pamjaftueshme në lidhje me pasuritë garazhe. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e këtij konstatimi.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit**

**45.5.** Në parashtrime subjekti vijon të japë të njëjtat sqarime në lidhje me burimin e krijimit të dy garazheve, pra që janë blerë si rrjedhojë e diferencës së çmimit të paguar në vitin 2005 për blerjen e apartamentit me sip. 131.1 m<sup>2</sup> në Tiranë, me çmimin e parashikuar në kontratën e shitjes së vitit 2007, pretendim i cili është vlerësuar i pabazuar. Në analizën financiare të viteve 2007 dhe 2008, të paraqitur nga subjekti në parashtrime, ai nuk ka pasqyruar shpenzime për të blerë pasuritë garazhe, por ka përllogaritur si të ardhur diferencën prej 7.141 euro<sup>34</sup>, e cila nuk është deklaruar në asnjë DPV, por që sipas sqarimeve që ka dhënë në pyetësorin nr. 2 i janë kthyer nga shitësi i apartamentit me sip. 131.1 m<sup>2</sup> gjatë vitit 2007. Për shkak të deklarimit të kësaj shume si e ardhur vetëm gjatë procesit të rivlerësimit, ku pretendim nuk u mor në konsideratë.

Bazuar në sa më sipër, subjekti nuk ka kundërshtuar barrën e provës në lidhje me dy pasuritë garazhe, për të cilat nuk ka plotësuar kriteret e parashikuara në pikën 1 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe bazuar në shkronjat “a” dhe “b” të nenit 33 të ligjit ka kryer deklarime të pasakta e të pamjaftueshme në lidhje me këto dy pasuri.

**46. Automjet tip “Mercedes-Benz”, prodhim i vitit 2001, me targë \*\*\***, blerë me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.8.2014, regjistruar në emër të vajzës E. B. Krijuar nga shitja e mjetit me targë \*\*\*, me kontratën nr. \*\*\*, datë 31.7.2014, në vlerën 3.000 euro, blerë me kursimet e familjes me kontratën nr. \*\*\*, datë 13.6.2012, në vlerën 200.000 lekë. Vlera: 3.000 euro. Pjesa takuese nuk është deklaruar.

**46.1.** Në lidhje me këtë automjet, nga aktet në dosje<sup>35</sup> rezultoi se sipas librezës së mjetit (në gjuhën gjermane) me targë \*\*\* figuron i regjistruar në datën 20.4.2001, me pronar shtetasin M. H., i cili në datën 13.9.2011 ia shet shtetasen V. J. në vlerën 1.000 euro, mjet i cili figuron në pronësi të saj me targë \*\*\*, sipas certifikatës së pronësisë datë 9.11.2011. Sipas kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.8.2014, shtetasja V. J. i shet shtetasen E. B., vajza e subjektit, mjetin me targë \*\*\*, në vlerën 3.000 euro. Sipas certifikatës së pronësisë datë 9.10.2014 mjeti figuron në pronësi të shtetasen E. B. Në DPV-në e vitit 2014 subjekti ka deklaruar blerjen e mjetit me targë \*\*\* në emër të vajzës së tij.

**46.2. Në lidhje me burimin e krijimit nga të ardhurat e shitjes së automjetit me targë \*\*\* rezulton se:**

- Me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.7.2014, vajza e subjektit E. B. i shet mjetin tip “\*\*\*\*” me targë \*\*\* shtetasit E. B., në vlerën 3.000 euro. Në DPV-në e vitit 2014 subjekti e ka deklaruar shitjen e këtij mjeti si burim krijimi për mjetin objekt verifikimi.

- Sa i takon automjetit me targë \*\*\*, subjekti ka paraqitur kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.6.2012, sipas së cilës shtetasja E. B. i ka blerë shtetasit A. D. mjetin tip “\*\*\*\*” me targë \*\*\* (i njëjti numër shasie), në vlerën 200.000 lekë. Blerjen e këtij mjeti subjekti e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2012, në shumën 200.000 lekë, me të ardhura nga pagat, ndërsa në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si burim kursimet e familjes.

<sup>34</sup> Diferenca e: 67.069 euro çmimi sipas deklaratës noteriale -52.440 euro, çmimi sipas kontratës së shitjes së apartamentit -7.488 euro, çmimi i blerjes së dy garazheve.

<sup>35</sup> Shihni aneksin nr. \*\*\* dhe aneksin nr. \*\*\* në dosjen ILDKPKI dhe shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.11.2021, të DPSHTRR-së në dosjen e Komisionit.

- I pyetur në lidhje me shitjen në një çmim më të shtrenjtë nga ai i blerjes, rreth 2 vite më pas, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti sqaron se përveç investimit të bërë për mirëmbajtjen e mjetit ka qenë edhe negocimi me blerësin që ka dakordësuar me çmimin, por nuk ka dhënë informacion apo dokumentacion për të verifikuar investimet e bëra në këtë mjet.

- Pas verifikimeve të kryera<sup>36</sup> nuk rezultoi konflikt interesi me shtetasit A. B. D. dhe E. M. B. apo përfshirje në veprimtari të krimit të organizuar.

**46.3.** Komisioni kreu analizën financiare për blerjen e automjetit sipas kontratës së shitjes datë 13.6.2012, në çmimin 200.000 lekë, nga ku rezultoi një balancë e pakonsiderueshme negative prej 28.539 lekësh.

**46.4.** Në përfundim të hetimit është kryer analiza financiare për blerjen e automjetit objekt verifikimi sipas kontratës datë 19.8.2014, në vlerën 3.000 euro. Si e ardhur nga shitja e mjetit tip “\*\*\*\*” me targë \*\*\*, në datën 31.7.2014, nuk është konsideruar shuma 3.000 euro, sikurse parashikohet në kontratë, por 200.000 lekë, aq sa çmimi i blerjes së tij në vitin 2012. Analiza financiare përfshin si shpenzim edhe gjysmën e vlerës së shlyer të huas shtetasit N. Ll., pasi nuk është e njohur data ekzakte e shlyerjes prej 500.000 lekësh, siç deklarohet në DPV-në e vitit 2014 nga subjekti.

<b>Përshkrimi</b>	<b>1.1.2014 – 19.8.2014</b>
<b>Pasuritë</b>	<b>516,453</b>
Automjet me targë ***	418,110
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>	98,343
Gjendja e likuiditeteve	1,176,571
<b>Detyrime</b>	<b>-292,158</b>
Hua Raiffeisen Bank	(42,158)
Shlyer huaja N. Ll.	(250,000)
<b>Pasuri neto</b>	<b>808,611</b>
<b>Të ardhurat</b>	<b>1,554,931</b>
Paga subjekti	793,297
Paga bashkëshortja e subjektit	561,634
Të ardhura nga shitja e automjetit blerë në vitin 2012	200,000
<b>Shpenzimet</b>	<b>932,541</b>
Shpenzimet jetike	549,995
Shpenzime pagese kredie (interes)	54,362
Shpenzime udhëtimi në vendin e punës	85,569
Shpenzime TIMS	242,588
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-186,221</b>

**46.5.** Në përfundim të hetimit administrativ, duket se subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kanë justifikuar blerjen e automjetit në datën 19.8.2014 me të ardhura të ligjshme, për shkak të rezultatit negativ në shumën 186.221 lekë, si në tabelën më sipër. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e këtij konstatimi.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit**

**46.6.** Në parashtrimet e tij, subjekti kundërshton konsiderimin e shumës 200.000 lekë si e ardhur nga shitja e automjetit të blerë në vitin 2012, duke dhënë të njëjtat sqarime se çmimi i kontratës së shitjes së këtij mjeti në vlerën 3.000 euro në vitin 2014 është caktuar me vullnetin e palëve. Për shkak se nuk ka depozituar ndonjë dokumentacion shtesë që të justifikojë rritjen e vlerës së mjetit, në përfundim të procesit ky pretendim i cili mbetet në nivel deklarativ u konsiderua i pabazuar. Por, për shkak se në analizën financiare të rishikuar nuk janë

<sup>36</sup> Shihni shkresat: nr. \*\*\* prot., datë 27.6.2023, të PGJSHJPJ-së Dibër; nr. \*\*\* prot., datë 26.6.2023, të PGJSHJPJ-së Shkodër; nr. \*\*\* prot., datë 6.7.2023, të PGJSHJPJ-së Lezhë; nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2023, të PGJSHJPJ-së Durrës; nr. \*\*\* prot., datë 4.7.2023, e SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

konsideruar shpenzimet për shlyerjen e huas shtetasit N. Ll., në përfundim të procesit balanca nga negative kthehet në pozitive, në vlerën 42.772 lekë.

**47. Gjendje cash në vlerën 600.000 lekë**, krijuar deri në datën 31.12.2016, nga kursimet nga pagat e marra nga subjekti, bashkëshortja dhe vajza. Në lidhje me këtë likuiditet, u kryen verifikimet si vijojnë:

- Në deklaratën *Vetting* subjekti deklaroi gjendje cash vlerën 600.000 lekë, krijuar deri më 31.12.2016 nga kursimet nga pagat e tij, bashkëshortes dhe vajzës. Ndërsa në DPV-në e vitit 2016 subjekti deklaroi: “*Shtuar gjendja cash gjatë vitit 2016 bashkë me vitet e tjera; kursime dhe një pjesë e kredisë së marrë datë 13.5.2016*”. Pra nuk është e qartë sa është gjendja cash në datën 31.12.2016 dhe cili është burimi i krijimit të tij.

- Në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI<sup>37</sup>, subjekti deklaroi gjendje cash në datën 31.12.2014 vlerën 400.000 lekë. Gjithashtu, deklaroi se në vitet e mëparshme ka deklaruar kursimet e çdo viti, të cilat janë përdorur në vitin pasardhës për pushime vjetore.

- Gjatë procesit është pyetur subjekti për të saktësuar gjendjet cash në çdo fundvit, si dhe cili është destinacioni i përdorimit të shumës 1.400.000 lekë, që është diferenca mes gjendjes cash të përlllogaritur nga ana e Komisionit dhe vlerës 600.000 lekë të deklaruar në deklaratën *Vetting* nga subjekti.

- Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi se në fund të vitit 2016 totali i gjendjes cash ka qenë 600.000 lekë, e krijuar nga të ardhurat nga pagat dhe kredia e marrë atë vit, por pa saktësuar vlerat përkatëse. Po kështu deklaroi se për shkak të moskuptimit të qartë nga ana e tij e pyetjes lidhur me kursimet e shtuara cash të familjes, ka deklaruar çdo vit gjendjen totale të tyre dhe jo vetëm pjesën e shtuar. Në tabelën më poshtë paraqitet përmbledhtas gjendja cash në fund të çdo viti sipas deklarimeve të subjektit ndër vite dhe shpjegimeve të dhëna në pyetësorin nr. 2:

Viti	Gjendja në fund të vitit sipas deklarimeve në DPV	Gjendja sipas sqarimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ
2003	-	-
2004	500,000	500,000
2005	500,000	-
2006	500,000	-
2007	-	-*
2008	-	-
2009	200,000	200,000
2010	600,000	400,000
2011	900,000	300,000
2012	900,000	-
2013	1,100,000	200,000
2014	1,300,000	200,000
2015	1,400,000	100,000
2016	2,000,000	600,000

\*Deklaron se janë depozituar në llogarinë bankare kursimet e këtij viti për t'u përdorur për shkollimin e vajzës vitin pasardhës.

Në sqarimet e dhëna, vërehet se ka mospërputhje në deklaratimet e subjektit për sa i përket: (i) burimit të krijuar për depozitat bankare të vitit 2007, pasi në DPV-në e vitit 2007 deklaroi depozitimin e shumave 252.679 lekë, 4.000 USD dhe 4.332 euro nga kursimet në vite në llogarinë e bashkëshortes (trajtuar më poshtë), ndërsa në shpjegimet e dhëna në pyetësorin nr. 2 deklaroi se në vitin 2007, për të cilin gjendja cash është 0 (zero), janë depozituar në llogari bankare kursimet e këtij viti për t'u përdorur për shkollimin e vajzës në vitin pasardhës; (ii)

<sup>37</sup> Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 9.11.2021, të ILDKPKI-së në dosjen e Komisionit.

gjendjes *cash* të vitit 2014 prej 200.000 lekësh nga ajo e deklaruar në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, ku subjekti deklaroi shumën 400.000 lekë në datën 31.12.2014.

- Sa më lart, pretendimi i subjektit se ka deklaruar çdo vit gjendjen totale të gjendjes *cash* dhe jo vetëm pjesën e shtuar janë kontradiktore me vetëdeklarimet e tij gjatë pyetjes pranë ILDKPKI-së dhe të pambështetura në kërkesat e ligjit, i cili parashikonte shprehimisht detyrimin e subjekteve për deklarimin e shtesave, sikurse vetë subjekti është shprehur në përshkrimet e tij në çdo rast. Për këto arsye, në analizën financiare është konsideruar gjendja *cash* sipas raportimeve periodike ndër vite, sipas të cilave në fund të vitit 2016 ai ka pasur 2.000.000 lekë *cash*. Por, duke qenë se në deklaratën *Vetting*, dorëzuar në datën 26.1.2017, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në vlerën 600.000 lekë, e cila justifikohet me të ardhura të ligjshme, është i paqartë destinacioni i shumës 1.400.000 lekë. Subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim.

- Në parashtrimet e veta, subjekti sqaron ashtu si edhe gjatë hetimit administrativ, se gjendja *cash* e konsideruar nga ana e Komisionit në analizën financiare është rrjedhojë e keqkuptimit të likuiditeteve (kursimeve *cash*) nga ana e tij ndër vite, duke dhënë të njëjtat sqarime se në plotësimin e deklaratës periodike vjetore ndër vite dhe për shkak të moskuptimit qartë nga ana e tij e pyetjes lidhur me kursimet e shtuara *cash* të familjes, ka deklaruar çdo vit gjendjen totale të tyre në fund të vitit dhe jo vetëm pjesën e shtuar. Subjekti nuk ka dhënë ndonjë sqarim në lidhje me konstatimet e Komisionit në lidhje me mospërputhjet e burimit të gjendjes *cash* të depozituar në llogaritë e bashkëshortes gjatë vitit 2007, si dhe mospërputhjes së gjendjes *cash* të deklaruar në fund të vitit 2014 në sqarimet në ILDKPKI dhe atë të deklaruar gjatë hetimit administrativ, në pyetësorin nr. 2.

**47.1.** Në përfundim të procesit, ashtu sikurse edhe në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni vlerësoi që gjendja e likuiditeteve *cash* të konsiderohet sipas deklarimeve në DPV. Edhe sikur pretendimi i subjektit të merrej në konsideratë, kjo nuk do të kishte ndonjë efekt të qenësishëm në analizën financiare, pasi balanca negative e analizës financiare e periudhës 2004 – 2016 (pasqyruar në përfundim të hetimit administrativ për kriterin e pasurisë) do të ndryshonte nga -6.711.323 lekë në -6.386.237 lekë. Ndërkohë, për Komisionin mbetet ende i paqartë destinacioni i shumës 1.400.000 lekë.

**48. Llogari rrjedhëse e pagës nr. \*\*\* në Raiffeisen Bank.** Gjendja me datë 24.1.2017 është -133.621 lekë (përdorur *overdraft*-i). Nuk u evidentuan problematika në lidhje me këtë llogari bankare.

**49. Mastercard** hapur me kontratën datë 11.2.2014 me afat 3-vjeçar dhe limit maksimal 70.000 lekë. Nr. i llogarisë \*\*\*. Gjendja: rreth 22.000 lekë. Nuk u evidentuan problematika në lidhje me këtë llogari bankare.

## DETYRIMET FINACIARE

**50.** Kredi në Raiffeisen Bank me kontratë kredie bankare datë 13.5.2016, në vlerën 1.500.000 lekë, për të cilën rezultoi se:

**50.1.** Raiffeisen Bank<sup>38</sup> konfirmon se subjekti është financuar me një kredi në shumën 1.500.000 lekë në datën 16.5.2016, nëpërmjet të cilës është mbyllur balanca e mbetur e kredisë së marrë në datën 30.3.2007. Banka informon se kredia e marrë në vitin 2016 është mbyllur nëpërmjet një kredie të re të marrë po në këtë bankë në datën 30.3.2020. Bashkëlidhur shkresës gjendet kontrata e kredisë bankare nënshkruar mes palëve në datën 13.5.2016, me afat 84 muaj dhe normë interesi fikse prej 6.9% për 3 vitet e para e më pas \*\*\* 1-vjeçar + 9.6%. Qëllimi i kredisë është përdorimi për arsye personale. Bashkëshortja e subjektit ka nënshkruar në cilësinë e bashkëkredimarrëses. Nga ekstrakti i llogarisë bankare të subjektit verifikohet disbursimi i vlerës prej 1.500.000 lekësh në datën 16.5.2016, prej së cilës vlera prej -

<sup>38</sup> Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 8.3.2021, të Raiffeisen Bank në dosjen e Komisionit.

1.204.394,62 lekësh është transferuar për mbylljen e balancës së mbetur të principalit të kredisë ekzistuese marrë në vitin 2007. Konfirmohet deklarimi i subjektit për sa i takon kredisë së disbursuar në Raiffeisen Bank në datën 16.5.2016, në vlerën 1.500.000 lekë dhe balancës së mbetur të detyrimit prej 1.419.581,71 lekësh në datën 31.12.2016.

**51.** Personi i lidhur S. Q. B., bashkëshortja e subjektit, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale” ka deklaruar: “Llogari rrjedhëse e pagës sime në Societe Generale Albania, me nr. \*\*\*. Gjendja në datën 23.1.2017 është 1.061 lekë”. Nuk u evidentuan problematika në lidhje me këtë llogari bankare.

**52.** Personi i lidhur E. K. B., vajza e subjektit, në deklaratën *Vetting*, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale” ka deklaruar: “Llogari rrjedhëse e pagës sime në Credins Bank, me nr. \*\*\*. Gjendja në datën 24.1.2017 është 10.168 lekë”. Nuk u evidentuan problematika në lidhje me këtë llogari bankare.

**53.** Personi i lidhur E. K. B., vajza e subjektit, në deklaratën *Vetting* ka deklaruar automjet tip “Mercedes-Benz”, prodhim i vitit 2001, me targë \*\*\*, trajtuar tek pasuritë e subjektit të rivlerësimit.

### **KONSTATIME TË TJERA**

**54.** Në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI në vitin 2016, i pyetur në lidhje me automjete në pronësi apo në përdorim të tij, subjekti ka deklaruar se ka në përdorim mjetin në pronësi të motrës së tij, duke sqaruar se e përdor vetëm kur shkon në Tropojë për shkak të specifikës së rrugës, si dhe ka paraqitur prokurën e posaçme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.5.2013, pa afat, sipas së cilës shtetasja K. B. (motra e subjektit) i jep në përdorim subjektit mjetin me targë \*\*\*. Përdorimin e këtij mjeti subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe as në pyetësorin standard.

Me qëllim heqjen e çdo dyshimi për një mjet në pronësi të mundshme të subjektit të rivlerësimit, nga ana e Komisionit u kryen verifikimet si vijojnë:

**54.1.** Me kërkesë të Komisionit, DPSHTRR-ja vuri në dispozicion dosjen e mjetit me targë \*\*\*, nga aktet e së cilës vërehet se:

- Sipas faturës tatimore nr. \*\*\*, datë 14.4.2008, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. i ka shitur shtetasës E. P. automjetin tip “\*\*\*\*”, me xhama të errët, radio CD, fener mjegulle, disqe alumini, në vlerën totale 2.767.500 lekë.

- Sipas certifikatës së pronësisë datë 13.7.2008 mjeti u regjistrua në pronësi të shtetasës E. P., me targë \*\*\*.

- Sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 25.6.2010, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. me administrator N. D. Ll. i shtetases K. B. mjetin me targë \*\*\*, në vlerën 13.000 euro. Për Komisioni ka qenë e paqartë përse mjeti nuk është shitur nga pronarja e tij E. P. Në kontratë përcaktohet se pronësia vërtetohet me gjithë dokumentacionin e plotë ligjor, por në dosje nuk figuron asnjë dokument fitimi pronësie nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. Në këto kushte, ka qenë e paqartë si është shitur mjeti pa titull pronësie në emër të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

- Sipas certifikatës së pronësisë datë 29.6.2010 mjeti figuron në pronësi të shtetasës K. B., me targë \*\*\* dhe sipas vërtetimit datë 7.3.2012 kjo shtetase ka kallëzuar humbjen e targës \*\*\*.

- Sipas certifikatës së pronësisë datë 9.3.2012 mjeti u regjistrua në pronësi të shtetasës K. B., me targë \*\*\*.

- Me kontratën nr. \*\*\*, datë 8.11.2018, shtetasja K. B. i ka shitur mjetin me targë \*\*\* shtetasit L. K., e regjistruar në emër të këtij të fundit me certifikatën datë 12.12.2018.

**54.2.** Nga të dhënat e sistemit TIMS rezulton se subjekti i rivlerësimit ka përdorur këtë mjet me targën \*\*\*, në datën 20.6.2010, që sipas AMF-së ka qenë në pronësi të shtetasës E. P., si

dhe më pas e ka përdorur disa herë edhe me targat \*\*\* dhe \*\*\* deri në vitin 2018 (114 herë hyrje-dalje), kur mjeti ka qenë në pronësi të shtetasës K. B. Ndërsa motra e subjektit K. B. nuk e ka përdorur asnjëherë këtë mjet. Në deklaratën *Vetting* subjekti nuk e ka deklaruar këtë mjet në përdorim dhe po ashtu as në pyetësin standard nuk ka deklaruar se ai ka pasur autorizim për përdorim të mjetit në pronësi të motrës.

- Nga verifikimi në sistemin e AMF-së vërehet se shtetasja K. B. përveç pronësisë së mjetit me targë \*\*\*, në periudhën 2015 – 2017 figuron edhe përdorues e mjetit me targë \*\*\* në pronësi të shtetasit F. I. Në policën e vitit 2013 – 2014 mjeti me targë \*\*\* figuron në pronësi të shtetasit F. I. me përdorues K. I. Në policën e vitit 2015 – 2016 mjeti me targë \*\*\* figuron në pronësi të shtetasit F. I. me përdorues K. B. dhe K. B., babai i saj dhe subjektit. Në policën e vitit 2016 – 2017 mjeti me targë \*\*\* figuron në pronësi të shtetasit F. I. me përdorues K. B. dhe E. M.

- Nga kërkimi në internet<sup>39</sup> rezulton se shtetasit F. dhe K. I. janë persona të shoqëruar nga policia, të dyshuar si bashkëpunëtorë në operacionin “\*\*\*\*” të vitit 2015. Nga kërkimi në internet rezulton edhe shtetasi E. M., i përmendur në veprimtari kriminale. Nga kërkimi në sistemin e Gjykatës së Lartë rezulton çështja penale nr. \*\*\*\*, me palë Prokuroria e Krimeve të Rënda kundër K. I., për masë arresti.

- SPAK-u<sup>40</sup> ka konfirmuar se për shtetasin F. I. nuk rezulton të jetë regjistruar procedim penal/pasuror, ndërsa për shtetasin K. H. I., i datëlindjes 1.12.1968, në datën 18.12.2014 është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*\* në ngarkim të tij etj., dërguar për gjykim në datën 31.3.2016 për veprën penale të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal dhe gjatë shqyrtimit të çështjes gjyqësore ka ndërruar jetë. Nga ana e Komisionit janë ngritur dyshime për kontakte të papërshtatshme të motrës dhe babait të subjektit me shtetasin K. H. I., për të cilën subjekti nuk ka kryer deklarime në deklaratën për kontrollin e figurës.

- Nga kërkimet nuk u vërtetua që subjekti të ketë trajtuar çështjet që i përkasin shtetasve F. e K. I. dhe E. P.<sup>41</sup>

**54.3.** Subjektit i janë kërkuar sqarime e dokumente me pyetësin nr. 3, si: (i) të japë shpjegime për mosdeklarim të përdorimit të mjetit në deklaratën *Vetting*; (ii) të paraqesë dokumentet e fitimit të pronësisë së mjetit nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.; (iii) të provojë të ardhurat e ligjshme të motrës për blerjen e mjetit në vlerën 13.000 euro; (iv) të japë të dhëna dhe sqarime të plota e shteruese mbi personat F. dhe K. I., marrëdhëniet e motrës dhe babait me këta shtetas dhe shkaqet përse motra figuron përdoruese e këtij mjeti kur ka në pronësi mjet të saj; (v) të japë sqarime për faktin se ky mjet është përdorur vetëm nga ai dhe asnjëherë nga motra e tij; (vi) të sqarojë marrëdhënien e tij me shtetasen E. P. dhe cilat janë rrethanat e përdorimit të mjetit që kur ky mjet ka qenë në pronësi të saj.

**54.4.** Në përgjigje të pyetësit të nr. 3 subjekti sqaroi si vijon:

- Në lidhje me mosdeklarimin e automjetit në deklaratë *Vetting*, subjekti pretendon se ka qenë një pakujdesi e paqëllimshme që sipas tij ka ardhur si pasojë e raporteve familjare. Subjekti sqaroi se këtë mjet e ka deklaruar në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, ndërkohë që është verifikuar se ai ka kryer deklarime në lidhje me këtë mjet me kërkesë të institucionit. Nga Komisioni është vlerësuar se nuk justifikohet mospërmbushja e detyrimit ligjor për deklarimin e mjetit në përdorim, sidomos në kushtet kur u vërtetua që është përdorur rregullisht dhe për një periudhë të gjatë kohore vetëm nga subjekti.

- Sa i takon fitimit të pronësisë së mjetit nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., paraqiti kontratën nr. 4479/1710, datë 27.5.2010, sipas së cilës shtetasja E. P. i shet shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.,

<sup>39</sup> [https://www.\\*\\*\\*-shqip.com/\\*\\*\\*\\*/](https://www.***-shqip.com/****/)

<sup>40</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.8.2023, të SPAK-ut në dosjen e Komisionit.

<sup>41</sup> Shihni shkresat: nr. \*\*\* prot., datë 25.8.2023, të PGJSHPJP-së Dibër; nr. \*\*\* prot., datë 7.8.2023, të PGJSHPJP-së Durrës; nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2023, të PGJSHPJP-së Lezhë; nr. \*\*\* prot., datë 4.9.2023, të PGJSHPJP-së në dosjen e Komisionit.



përfaqësuar nga shtetasi N. Ll., mjetin me targë \*\*\* në shumën 13.000 euro. Për më pak se një muaj, mjeti u ble me kontratën nr. \*\*\*, datë 25.6.2010, nga shtetasja K. B. dhe duke qenë se në atë kohë nuk kishte ndonjë pengesë ligjore formale, është bërë kontratë mbi kontratë (pra duket se mjeti nuk është regjistruar në emër të shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. dhe shitja është bërë bazuar në aktin e fitimit të pronësisë me datë 27.5.2010). Sipas subjektit kjo ka qenë edhe arsyeja përse rezulton që mjeti është përdorur nga ai ndërkohë ishte ende në pronësi të shtetasës E. P.

- Sa i takon faktit që këtë mjet motra K. B. nuk e ka përdorur asnjëherë, subjekti sqaroi se ajo që prej vitit 1992 jeton me prindërit në fshatin \*\*\*, Tropojë. Për shkak të moshës së thyer të prindërve dhe përkeqësimit të gjendjes shëndetësore të vëllait të tij, i cili ndërroi jetë në vitin 2011, prindërit dhe motra i kanë kërkuar të gjente një automjet që ta blinin në mënyrë që të përdorej kryesisht nga vetë ai për t’u kujdesur për prindërit. Kjo sipas tij, për faktin se vetëm ai mund të kujdesej dhe se në atë kohë ndodhej me detyrë në Shkodër dhe vendbanim në Tiranë. Për Komisionin mbetej e paqartë përse mjeti do të përdorej nga subjekti, ndërkohë që motra jetonte me prindërit dhe mund të përkujdesej për ta duke përdorur mjetin.

- Në lidhje me përdorimin e mjetit në pronësi të shtetasit F. I. nga babai dhe motra e tij, ka sqaruar se kunati i tij L. S., punonjës në administratën e Gjykatës Kushtetuese, e ka njohur gjatë riparimeve të mjetit shtetasin F. I., i cili kishte një servis makinash, që donte të shiste mjetin në një vlerë prej 1.000.000 lekësh për shkak të amortizimit. Me shpresën për ta përdorur e motra, babai K., i ndërmjetësuar nga kunati, ka blerë mjetin me targë \*\*\* me kontratën nr. \*\*\*, datë 17.11.2015, në çmimin 100.000 lekë, i cili nuk është regjistruar për shkak se nuk u bë i vlefshëm për t’u përdorur. Siç vërehet nga vetë deklaratimet e subjektit, duket se ky mjet është blerë për ta përdorur motra e subjektit, ndërkohë që ajo ka pasur në pronësi mjetin që përdorej nga subjekti.

- Në lidhje me njohjet dhe marrëdhëniet me shtetasit F. I., K. I. dhe E. M., sqaroi se as ai dhe as motra nuk kanë asnjë lloj raporti apo njohje me shtetasit F. I. dhe K. I., ndërsa me shtetasin F. I. babai ka pasur kontakt vetëm ditën e shitblerjes së mjetit. Ndërsa me shtetasin E. M. sqaroi se kanë raporte miqësore, pasi është banor i fshatit \*\*\*, Tropojë dhe mbesa e subjektit është martuar me kushëririn e tij dhe se ky e ka përdorur mjetin disa herë më qëllim për ta riparuar.

- Sa i takon të ardhurave të ligjshme të motrës për blerjen e këtij automjeti, subjekti sqaron se motra e tij ka jetuar me prindërit, të cilët në vitet 1991 – 1993 janë në pension si ish-mësues, duke vënë në dispozicion të Komisionit vërtetimet e pensioneve<sup>42</sup>. Sipas subjektit, nga viti 1992 e në vazhdim, prindërit e tij dhe motra K. kanë administruar edhe tokën në pronësi të babait të tij, duke zhvilluar ekonomi bujqësore dhe blegtorale. Babai i tij ka në fshatin \*\*\*, Tropojë, 8.172 m<sup>2</sup> tokë të regjistruar<sup>43</sup> dhe rreth 8.000 m<sup>2</sup> tokë pyll të paregjistruar, por të konfirmuar nga Njësia Administrative \*\*\*, duke bashkëngjitur certifikatat e pronësisë së pronave të regjistruara dhe vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 24.8.2023, të Njesisë Administrative \*\*\*. Prindërit e tij kanë dalë në pension në moshë të re e me fizik të fortë dhe kanë zhvilluar ekonomi bujqësore dhe blegtorale ku një pjesë e madhe prodhimeve destinohej në treg, pasi nevojat familjare prej tre personash ishin të kufizuara. Shitja e produkteve bujqësore/blegtorale siguronin të ardhura monetare të konsiderueshme për prindërit e tij. Shitja e këtyre produkteve është kryer në mënyrë ambulatorë, pa iu nënshtruar tatimit në burim.

---

<sup>42</sup> Shihni: vërtetimin masë pensioni K. B., për periudhën 1.7.1993 – 31.12.2005, me nr. \*\*\* prot., datë 31.8.2023 dhe për periudhën 1.1.2006 – 31.8.2023, me nr. \*\*\* prot., datë 22.8.2023, të Drejtorisë Rajonale ISSH B. C.; vërtetimin masë pensioni H. B., për periudhën 1.8.1991 – 31.12.2004, me nr. \*\* prot., datë 31.8.2023 dhe për periudhën 1.1.2005 – 31.8.2023, me nr. \*\*\* prot., datë 22.8.2023, të Drejtorisë Rajonale ISSH Bajram Curri në dokumentacionin e pyetësorit nr. 3, në dosjen e Komisionit.

<sup>43</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.7.2023, të ASHK Tropojë, janë konfirmuar tokat arë dhe pemëtoare në pronësi të shtetasit K. B.



Për të mbështetur sqarimet e tij, subjekti ka paraqitur deklarata të disa shtetasve, të cilët deklarojnë se kanë blerë produkte të ndryshme bujqësore/blegtorale, sipas nevojës, tek babai i subjektit gjatë periudhës 2004 – 2010, për të cilat nuk vërtetohen të ardhura të ligjshme në kuptim të ligjit. Në këto kushte, në analizën financiare nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat nga bujqësia e blegtoria.

**54.5.** Sa i takon të ardhurave të motrës K. B., subjekti me *email*-in e dërguar në datën 19.9.2023 ka paraqitur dokumente që vërtetojnë të ardhura nga puna e saj si laborante<sup>44</sup>. Për efekt të verifikimit të mundësisë së motrës së subjektit për të blerë në vitin 2010 me të ardhura të ligjshme, në konsideratë të të ardhurave të vërtetuara prej punës së saj në periudhën 2003 – 25.6.2010 në shumën 1.616.262 lekë dhe shpenzimeve për një person prej 885.212 lekësh, duket se ajo nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për shkak të balancës negative prej 1.049.300 lekësh. Edhe duke i reduktuar shpenzimet e jetesës në 50%, referuar deklarimeve të subjektit se ajo ka jetuar në fshat me prindërit, të cilët kanë disponuar tokë bujqësore dhe kanë përfituar nga produktet bujqësore e blegtorale, balanca negative ulet në vlerën -606.694 lekë. Referuar kësaj balance, duke pasur në konsideratë që motra e subjektit ka pasur minimalisht shpenzime udhëtimi për vajtje-ardhje ditore për të shkuar në punë në qytetin e Tropojës, është vlerësuar se ajo ka qenë në pamundësi për të blerë mjetin në vitin 2010 në çmimin 13.000 euro. Por, edhe sikur të justifikohesh blerja e mjetit me të ardhura të ligjshme nga motra, subjekti nuk ka deklaruar sipas ligjit në deklaratën *Vetting* përdorimin dhe posedimin e mjetit vetëm prej tij dhe menjëherë pasi motra e bleu mjetin, duke krijuar dyshime të arsyeshme që mjeti është në pronësi të fshehur prej tij.

**54.6.** Sa i takon kontaktit të papërshtatshëm të motrës dhe babait të subjektit me shtetasin K. H. I., person i përfshirë në krimin e organizuar, nuk u vërtetua dijenia e subjektit në lidhje me këtë fakt apo ndonjë raport mes motrës së tij me këtë shtetas, e për pasojë nuk u gjend në një deklaram të pasaktë në deklaratën për kontrollin e figurës.

**54.7.** Bazuar në sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me mjetin në pronësi të motrës së subjektit dhe përdorur nga ky i fundit, rezultoi se:

- Subjekti është sjellë si pronar i mjetit pasi nga të dhënat e sistemit TIMS, por edhe nga deklaramet e tij, mjeti është përdorur rregullisht vetëm prej tij që në momentin e blerjes nga motra K. B., e cila nuk e ka përdorur atë, ndërkohë që është vërtetuar të ketë udhëtuar me mjete të tjera.

- Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* posedimin, përdorimin dhe burimin e krijimit të tij, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 84/2014 dhe sikurse ka kërkuar formulari i deklarimit për deklaratën *Vetting* të pasurive.

- Motra e subjektit (sikurse edhe vetë subjekti) nuk justifikon blerjen e mjetit me të ardhura të ligjshme.

Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të vërtetojë që nuk është në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit**

**54.8.** Në parashtrimet e tij subjekti në mënyrë të përmbledhur pretendon se:

- Sa i takon faktit që motra e tij nuk figuron të ketë udhëtuar me mjetin sipas të dhënave të sistemit TIMS, sqaron se lëvizjet e motrës nuk kanë qenë të shpeshta dhe nëse kanë ndodhur kanë qenë në shoqërinë e tij.

---

<sup>44</sup> Shihni vërtetimin për bazën e vlerësuar nr. \*\*\* prot., datë 17.8.2023, të Degës së Sigurimeve Tropojë dhe nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore datë 21.8.2023.

- Në lidhje me mosdeklarimin e mjetit në deklaratën *Vetting*, vijon të mbajë të njëjtin qëndrim, që sipas tij ka qenë një pakujdesi e paqëllimshme, duke sqaruar se ai ka dhënë shpjegime në ILDKPKI.

- Lidhur me të ardhurat e ligjshme për blerjen e automjetit nga motra e tij K. B., subjekti i mbetet sqarimeve të dhëna në përgjigje të pyetësorëve nr. 3 dhe nr. 4 sipas të cilave motra dhe prindërit e tij kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e mjetit, për shkak edhe të të ardhurave nga ekonomia bujqësore. Siç vërehet, pretendimet e subjektit konsistojnë në faktin që në analizën financiare për blerjen e mjetit të përfshihen të ardhurat edhe të prindërve të tij dhe jo vetëm të motrës. Subjekti duket se i referohet të ardhurave të përfituara nga familjarët e tij në fshat, konkretisht: (i) të ardhurave nga pensioni i prindërve ndër vite; (ii) vlerës 600.000 lekë të përfitur nga shitja e një sipërfaqeje prej 600 m<sup>2</sup> toke ndaj bashkëfshatarit A. B. B. sipas deklaratës së datës 25.11.2006, konfirmuar edhe nga kryeplaku S. B.; (iii) vlerës 700.000 lekë, përfitur në vitin 2004 dhe vlerës 717.000 lekë, përfitur në vitin 2007 nga shitja e produkteve bujqësore/blegtorale sipas deklaratave të paraqitura nga subjekti gjatë hetimit administrativ. Për të dokumentuar këto të ardhura, subjekti nuk paraqiti ndonjë dokumentacion shkresor përveçse atyre të depozituara në pyetësorët nr. 3 dhe nr. 4.

**54.9.** Sa i përket pretendimit se në analizën financiare duhet të përfshihet e ardhura prej 600.000 lekësh nga shitja e tokës sipas deklaratës me shkrim dore datë 25.11.2006, të paraqitur në përgjigje të pyetësorit nr. 3, nuk gjendet i bazuar pasi, pa u ndalur në vërtetësinë e saj, nuk u paraqit asnjë dokument ku të provohet pronësia, shitja apo shlyerja e detyrimeve tatimore. Sa i takon të ardhurave nga bujqësia e blegtoria referuar deklaratave të disa shtetasve të cilët deklarojnë se kanë blerë produkte të ndryshme bujqësore/blegtorale sipas nevojës tek babai i subjektit gjatë periudhës 2004 – 2010, pohimet në këto akte mbeten në kuadër deklarativ dhe nuk vërtetojnë të ardhura të ligjshme në kuptim të ligjit. Nga ana tjetër, në analizën e kryer nga Komisioni janë reduktuar shpenzimet jetike të motrës në 50%, pikërisht për shkak se ajo së bashku me familjen kanë jetuar në fshat.

**54.10.** Në përfundim të procesit, Komisioni vlerësoi se motra e subjektit (por edhe ajo së bashku me prindërit), nuk ka/kanë pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e mjetit në vlerën 13.000 euro. Por, edhe nëse prindërit së bashku me motrën do të kishin të ardhura të mjaftueshme për blerjen e mjetit, kjo nuk vërteton faktin që mjeti nuk është në pronësi të fshehur të subjektit të rivlerësimit, në rastin kur ka rrethana që ngrenë dyshime të arsyeshme në lidhje me këtë fakt.

**54.11.** Sa i takon mosdeklarimit të përdorimit të automjetit në deklaratën *Vetting*, Komisioni arsyeton se, sipas nenit D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin dhe ky deklaram, në kuptim të pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë një deklaram i saktë dhe i plotë i pasurive në pronësi dhe përdorim. Nga ana tjetër, deklarata e pasurisë *Vetting*, sipas shtojcës 2, miratuar me ligjin nr. 84/2016, në nenin 31, pika 1 e tij përcakton deklaramin e pasurive në pronësi, posedim apo në përdorim.

**54.12.** Në përfundim të procesit, Komisioni vlerësoi se, pavarësisht se subjekti ka deklaruar përdorimin e mjetit në deklarimet pranë ILDKPKI-së në vitin 2014, në kushtet kur ky deklaram është kryer me kërkesë të këtij institucioni dhe jo me iniciativë të subjektit, si dhe referuar deklaratës së pasurisë *Vetting*, sipas shtojcës 2, e cila kërkon edhe deklaramin e burimit të krijimit të pasurive në përdorim, duke mbajtur në konsideratë edhe qëndrimin e mbajtur nga Kolegji<sup>45</sup>, Komisioni vlerëson se referuar rrethanave si: (i) subjekti është sjellë si pronar i mjetit, të cilin e ka përdorur rregullisht përmes një prokure të lëshuar nga motra K. B. menjëherë sapo ajo bleu mjetin me kontratën e shitjes datë 25.6.2010 (madje është lëshuar më parë se kjo datë, në datën 9.5.2013, kur mjeti ka qenë në pronësi të shtetasës E. P. për shkaqe

<sup>45</sup> Shihni vendimin nr. 13 (JR), datë 4.4.2023, paragrafi nr. 17.

të arsyetuara në paragrafin e dytë të pikës 54.4); (ii) motra e subjektit nuk e ka përdorur mjetin sipas të dhënave të sistemit TIMS, por edhe vetë deklarimeve të subjektit, i cili ka deklaruar se mjeti është blerë për t'u përdorur prej tij; (iii) motra e subjektit nuk ka pasur mundësi financiare për blerjen e mjetit në vlerën 13.000 euro; (iv) subjekti nuk ka deklaruar sipas ligjit në deklaratën *Vetting* dhe as në pyetësorin standard përdorimin e mjetit – subjekti i rivlerësimit nuk ka vërtetuar të kundërtën e barrës së provës që nuk është në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetues<sup>46</sup>, duke u përpjekur të fshehtë pasurinë në përdorim në deklaratën *Vetting*, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

**55.** Nga verifikimi në sistemin TIMS rezultoi se subjekti ka udhëtuar me disa automjete, për të cilat me kërkesë të Komisionit informoi mbi pronarët e tyre, marrëdhënien me ta, si dhe qëllimin e udhëtimeve. PGJSHPPJ-të<sup>47</sup> Dibër, Lezhë, Durrës dhe Shkodër kanë konfirmuar se subjekti nuk ka trajtuar çështje që i përkasin shtetasve që rezultuan pronarë/përdorues sipas sistemit AMF. Ndërsa SPAK-u ka konfirmuar se shtetasi E. Gj., që sipas AMF-së është pronari i mjetit me targë \*\*\*, është proceduar dhe dënua<sup>48</sup> (trajtuar tek figura).

**56.** Gjatë vitit 2007, në llogarinë e bashkëshortes së subjektit pranë Intesa Sanpaolo Bank janë kryer depozitimet *cash*: (i) në datën 21.5.2007 vlera 4.000 USD; (ii) në datën 2.8.2007 vlera 3.000 euro; (iii) në datën 10.10.2007 vlerat 1.200 euro dhe 178.000 lekë. Është kryer analiza financiare për mundësinë e krijimit të depozitave në llogaritë e bashkëshortes së subjektit në Intesa Sanpaolo Bank gjatë vitit 2007 sipas datave përkatëse dhe nga rezultati i saj duket se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme për depozitat e deklaruara deri në vitin 2007 për shkak të balancave negative, respektivisht 44.733 lekë, 276.990 lekë dhe 278.909 lekë.

**56.1.** Gjithashtu, sipas ekstraktit bankar të llogarisë në monedhën dollar të bashkëshortes së subjektit në Intesa Sanpaolo Bank, në datën 3.1.2008 është depozituar *cash* shuma 2.000 USD. Meqenëse në DPV-në e vitit 2007 nuk deklarohen kursime *cash*, nuk është i qartë burimi i kësaj depozite. Është kryer analiza financiare për mundësinë e kursimit dhe krijimit të kësaj depozite, nga e cila rezulton një balancë negative prej 215.014 lekësh.

**57.** Në lidhje me depozitat në llogarinë e bashkëshortes në Intesa Sanpaolo Bank në vitin 2007, në parashtrimet e tij subjekti ka sqaruar se balanca negative ka ardhur si rrjedhojë e deklarimit të gabuar të gjendjes së likuiditeteve *cash* nga ana e tij, duke paraqitur një analizë financiare, ku vërehet se është përfshirë si e ardhur shuma 7.141 euro, përfituar nga diferenca e çmimit të blerjes së apartamentit me sip. 131.1 m<sup>2</sup>, të cilën gjatë procesit të hetimit administrativ e ka deklaruar të kthyer nga shoqëria e ndërtimit gjatë vitit 2007 dhe nuk ka përfshirë vlerën e garazhit të blerë në vitin 2007. Ndërkohë, subjekti nuk ka dhënë ndonjë sqarim në lidhje me burimin e depozitës prej 2.000 USD në datën 3.1.2008 në llogarinë e bashkëshortes së tij. Pretendimet e subjektit, sikurse është arsyetuar më sipër në këtë vendim, nuk janë marrë në konsideratë e, për rrjedhojë, edhe analiza e kryer prej tij është vlerësuar e pabazuar.

**58.** ILDKPKI-ja ka konstatuar mosdeklarim në deklaratën *Vetting* dhe në deklarimet ndër vite të pasurisë apartament me sip. 25.03 m<sup>2</sup> në Kukës, përfituar nga privatizimi. Pas verifikimeve u vërtetua se kjo pasuri është shitur përpara vitit 2003 (trajtuar më gjerësisht në rezultatet e hetimit administrativ).

## **59. Në lidhje me gjeneralitetet e subjektit të rivlerësimit rezultoi se:**

---

<sup>46</sup> I cili parashikon: “Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.

<sup>47</sup> Shihni shkresat nr. \*\*\* prot., datë 25.8.2023, të PGJSHPPJ-së Dibër; nr. \*\*\* prot., datë 7.8.2023, të PGJSHPPJ-së Durrës; nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2023, të PGJSHPPJ-së Lezhë, nr. \*\*\* prot., datë 4.9.2023, të PGJSHPPJ-së Shkodër, në dosjen e Komisionit.

<sup>48</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.8.2023.

- Në DPFĐ-në e viteve 2003 – 2008, subjekti ka deklaruar gjeneralitetet Kujtim K. Basha, ndërsa nga DPV-ja e vitit 2009 e në vijim Kujtim K. Bashaj, ndërsa si datëlindje ka deklaruar gjithnjë 31.12.1961.

- Në shumë akte shkresore si deklarata/kontrata etj., subjekti ka deklaruar dhe nënshkruar me mbiemrin Basha, herë ka përdorur datën 31.10.1961 e herë datën 31.12.1961 dhe si vendlindje Tropojë.

- Sipas certifikatës së gjendjes familjare<sup>49</sup> datë 1.12.1992, subjekti dhe familjarë të tij e kanë mbiemrin Basha.

- Në certifikatën personale të paraqitur në deklaratën *Vetting* ka gjeneralitetet Kujtim K. Bashaj, i datëlindjes 31.10.1961, vendlindja Shkodër, si dhe shënimin “*Kujtim Bashaj ka korrigjuar muaji lindjes nga 31.10.1961 në 31.12.1961 sipas aktlindjes nr. \*\*\*, datë 15.1.1962, Shkodër, nr. \*\*\* prot., datë 14.11.2016*”.

- Në certifikatat familjare të datave 7.10.2010 dhe 5.8.2015, të paraqitura në pyetësonin standard, ka gjeneralitetet Kujtim K. Bashaj, i datëlindjes 31.10.1961, vendlindja Shkodër.

- I pyetur në lidhje me konstatimet si më sipër, në përgjigje të pyetësonit nr. 2 sqaroi duke paraqitur dokumentacion<sup>50</sup> si vijon:

i) Për sa i përket datëlindjes, nëpërmjet shkresës nr. \*\*\*, datë 18.11.2016, ka kërkuar korrigjimin në Zyrën e Gjendjes Civile si gabim material i hedhur nga shërbimi i gjendjes civile gjatë transferimit dhe në vijim është ndryshuar datëlindja nga 31.10.1961 në 31.12.1961, në bazë të aktit të lindjes të trungut familjar.

ii) Për sa i përket mbaresës “j” të mbiemrit, ndër vite ka kërkuar korrigjimin e tij, por ai ka marrë formën e saktë “Bashaj” me digjitalizimin e të dhënave në gjendjen civile, i cili për të vërtetuar formën e saktë të mbiemrit ka paraqitur edhe certifikatën familjare datë 30.3.2016, ku në bazë të regjistrimit të fshatit \*\*\*, në vitet 1950 – 1974, familja ka mbiemrin Bashaj, si dhe vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 17.7.2023, nga Njësia Administrative \*\*\*, sipas të cilit Kujtim Bashaj me nr. personal \*\*\*, atësi K., amësi H., i datëlindjes 31.12.1961, është i njëjti person me Kujtim Basha, atësi K., amësi H., i datëlindjes 31.12.1961, lindur në Shkodër.

- Me kërkesë të Komisionit, DPGJC-ja<sup>51</sup> ndër të tjera ka informuar se shtetasi Kujtim Bashaj me ID \*\*\*, ka lindur në Shkodër, sipas aktit të lindjes nr. \*\*\*, datë 15.1.1962, me të dhëna atësi K., amësi H., i datëlindjes 31.12.1961. Rreth viteve 1991 – 1992 është vendosur në ZGJC Bashkia Kukës, me atësi K., amësi H. dhe transkriptim të gabuar të datëlindjes nga 31.12.1961 në 31.10.1961. Në datën 18.11.2016 është bërë korrigjimi i datëlindjes sipas aktit të lindjes, nga 31.10.1961 në 31.12.1961.

**59.1.** Sa më sipër, konstatohet se zyrtarisht subjekti ka pasur ndryshim vetëm të datëlindjes jo për shkak të tij, ndërsa sa i takon mbiemrit të tij Bashaj, ndryshe nga sa deklaroi subjekti, nuk rezultoi që në aktet e gjendjes civile të ketë qenë ndonjëherë Basha. Në këto kushte, aktet e vërtetimit të pronësive të pasurive të paluajtshme të paraqitura nga subjekti me mbiemër “Basha”, duket se janë për shkak të deklaratimit të këtij mbiemri gjatë redaktimit të akteve noteriale. Megjithatë janë kryer hetime për të dy mbiemrat dhe nga përgjigjet e institucioneve nuk janë evidentuar pasuri të tjera të subjektit përveç atyre të deklaruara prej tij.

<sup>49</sup> Shihni aneksin nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>50</sup> Certifikatë familjare nr. \*\*\*, Tropojë, datë 30.6.2016, në bazë të regjistrimit të fshatit \*\*\* të viteve 1950 – 1974; vërtetim nga Njësia Administrative \*\*\*, Tropojë, datë 17.7.2023, i cili pohon faktin se Kujtim Bashaj dhe Kujtim Bashaj është njëjti person; akt lindjeje nr. \*\*\*, datë 15.1.1962, regjistri Shkodër; certifikatë lindjeje (nga akti) nr. \*\*\*, Shkodër, datë 1.11.2016; certifikatë personale nr. \*\*\*, datë 17.7.2023, ku cilësohet kryerja e korrigjimit të ditëlindjes bazuar në aktin e lindjes dhe trungun familjar.

<sup>51</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.8.2023, të DPGJC-së, në dosjen e Komisionit.

**60.** Nga ekstraktet e llogarisë bankare të subjektit pranë Raiffeisen Bank nr. \*\*\* (GBP) identifikohet depozitimi i shumës *cash* 5.000 GBP në datën 11.4.2006, e cila është tërhequr *cash* në datën 14.4.2006 nga subjekti. Subjekti, i pyetur në lidhje me këtë depozitë, burimin e krijimit dhe destinacionin e përdorimit të saj pas tërheqjes *cash*, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 deklaroi se kjo shumë i është nevojitur bashkëshortes si një prej kërkesave për të aplikuar për vizë për udhëtimin e saj dhe të vajzave në Londër. Ai deklaroi se kjo shumë është dhënë nga shtetasi L. Sh., e cila i është kthyer brenda 5 ditëve. Në mbështetje të deklaramit të tij, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 19.7.2023, të shtetasit L. Sh., i cili pohon deklaramet e subjektit. Pavarësisht se nuk ka të dhëna për të ardhurat e ligjshme që kanë shërbyer për dhënien e shumës 5.000 GBP, si dhe dhënia e shumës nuk është deklaruar në pyetësorin standard, nisur nga koha e shkurtër e tërheqjes nga dita e depozitimit, janë marrë në konsideratë deklaramet e subjektit dhe nuk janë kryer verifikime të mëtejshme.

**61.** Nga të dhënat e regjistrimit të Gjendjes Civile të vitit 2008 prindërit dhe motra e subjektit figurojnë me banim të dyfishtë në fshatin \*\*\*, Tropojë dhe në Tiranë, në adresën: rruga “\*\*\*\*”, pallati i ri, shkalla \*\*\*, ap. \*\*\*. Ndërsa nga të dhënat e regjistrimit të Gjendjes Civile të vitit 2014 figurojnë me adresë banimi vetëm në Tiranë, pa u përcaktuar adresa e plotë. Me *email*-in e datës 18.9.2023 subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me këtë adresë.

**61.1.** Në përgjigje të tij, me *email*-in e datës 19.9.2023, subjekti ka deklaruar se:

- Prindërit e tij nuk kanë banuar kurrë, për asnjë periudhë, në Tiranë, as në adresën e sipërpërshkruar dhe as në ndonjë adresë tjetër. Edhe motra K. B. fizikisht nuk ka banuar kurrë në Tiranë në adresën e sipërpërshkruar dhe as në ndonjë adresë tjetër. Gjithashtu, subjekti deklaroi se prindërit dhe motra e tij nuk kanë pasuri të tjera përveç shtëpisë së banimit dhe tokave në fshatin \*\*\*, Tropojë.

- Subjekti shpjegon se diku nga fundi i vitit 2007 apo fillimi i vitit 2008, motra ka diskutuar verbalisht për të vazhduar studimet e larta për laborante dhe kishte biseduar që të merrte një ambient banimi me qira në Tiranë, por për shkak të gjendjes së prindërve në moshë të thyer dhe rrethanave të tjera familjare ajo hoqi dorë nga kjo ide dhe nuk u regjistrua asnjëherë në fakultet. Më pas ajo u diplomua pa shkëputje nga puna në periudhën 3.11.2010 – 13.7.2014, duke e provuar sipas tij me vërtetimet e punës prej vitit 2003<sup>52</sup>.

- Sipas subjektit, transferimi, sidomos i prindërve, është realizuar pa kërkesën dhe pa dijeninë e tyre. Pas reagimit të tyre u është rikthyer përsëri Gjendja Civile në Tropojë, si dhe ata kanë votuar në \*\*\*, Tropojë.

- Subjekti sqaroi se nuk është në gjendje të identifikojë pasuri në adresën e sipërpërshkruar, që sipas tij, praktikisht bëhet fjalë për pallatin ku ai ka banuar deri në vitin 2022 dhe se në dijeninë e tij nuk ka pasur ndonjë apartament me nr. \*\*\* në atë shkallë dhe as në atë pallat.

**61.2.** Bazuar në deklaramet e subjektit mbetjet e paqartë: (i) si është bërë regjistrimi i prindërve dhe motrës së subjektit në regjistrat e Zyrës së Gjendjes Civile Tiranë; (ii) pse adresa e banimit është e njëjtë me atë të apartamentit të subjektit, me përjashtim të numrit të apartamentit; (iii) kur prindërit e subjektit kanë ndryshuar regjistrimin e adresës së banimit; (iv) cili është banimi aktual i tyre. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumente shkresore për të qartësuar këto fakte e rrethana dhe për të vërtetuar deklaramet e tij, me qëllim heqjen e çdo dyshimi për një apartament të mundshëm në pronësi të prindërve apo edhe vetë subjektit.

**61.3.** Në parashtrimet e tij subjekti dha të njëjtat sqarime si në përgjigje të pyetësorit nr. 4 (*email* datë 19.9.2023) sipas të cilave, në thelb, as motra dhe as prindërit e tij nuk kanë jetuar

---

<sup>52</sup> Subjekti paraqiti diplomë “Bachelor në Teknik i Lartë Laboratori” nga Universiteti i Mjekësisë Tiranë, përfituar nga përfundimi i detyrimeve akademike të programit me kohë të pjesshme dhe mbrojtjen e temës së diplomës datë 13.7.2014.

në Tropojë. Subjekti nuk paraqiti akte nga Zyra e Gjendjes Civile apo dokumente të tjera shkresore për të në lidhje me sa i është kërkuar nga Komisioni me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ. Në këto kushte, në përfundim të procesit Komisioni vlerësoi se subjekti nuk është treguar bashkëpunues me qëllim qartësimin e situatës dhe heqjen e dyshimeve të Komisionit dhe sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 ky fakt është mbajtur në konsideratë në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

## Analiza financiare

**62.** Për të verifikuar justifikimin e pasurive të deklaruara në deklaratën *Vetting* është kryer analiza financiare e subjektit bazuar në vlerën e pasurive, të ardhurat dhe shpenzimet dhe në përfundim të hetimit administrativ, subjektit iu kalua barra e provës për balancat negative të rezultuara nga analiza financiare për periudhën 1992 – 2003 (kur është bërë deklarimi i parë i pasurisë) dhe më pas për periudhën 1.1.2004 – 31.12.2016, respektivisht në balancat negative prej -408.736 lekësh dhe -12.599.479 lekësh.

### Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

**62.1.** Në parashtimet e tij subjekti ka paraqitur pretendimet në lidhje me analizën financiare, si dhe ka kryer analizën financiare për periudhën 2004 – 2016, ku shuma e viteve me balancë negative rezulton 1.725.043 lekë. Në këtë analizë janë konsideruar: (i) të ardhurat nga huat nga shtetasit N., Ll. dhe F.; (ii) të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip. 70 m<sup>2</sup> në vitin 2005; (iii) gjendja *cash* sipas deklarimeve gjatë procesit të hetimit dhe parashtime; (iv) e ardhur shumën 7.141 euro, e pretenduar si rrjedhojë e diferencës së çmimit të paguar në vitin 2005 me çmimin e apartamentit sipas kontratës së vitit 2007 minus çmimin e garazheve sipas kontratave respektive në vitet 2007 – 2008; (v) nuk janë konsideruar vlerat e garazheve, respektivisht 5.460 euro dhe 2.028 euro në vitet 2007 – 2008; (vi) vlera e shitjes së automjetit në vitin 2014 është konsideruar 3.000 euro.

**62.2.** Komisioni, pasi shqyrtoi prapësimet e subjektit të analizuara rast pas rasti si në këtë vendim, mori në konsideratë disa prej pretendimeve të tij, konkretisht: (i) konsiderimi e kredisë prej 12.000 USD të marrë pranë Bankës Amerikane (sot ISP) si burim për blerjen e apartamentit me sip. 70 m<sup>2</sup>, në Tiranë, në vitin 2001 dhe konsiderimin si burim të ligjshëm të shumës 4.000.000 lekë nga shitja e tij në vitin 2005; (ii) heqjen e shpenzimeve për blerje elektroshtëpiake në vlerat 1.200 euro dhe 1.000 euro, të përfshira në analizën financiare të viteve 2015 dhe 2016, meqenëse këto shpenzime janë kryer në vitet 2019 dhe 2020 (deklaruar në pyetësorin nr. 2). Po kështu, u vlerësua që shumat e deklaruara për shlyerjen e huave të marra nga shtetasit S. N. në vitin 2005 dhe N. Ll. në vitin 2010, të mos përfshihen si shpenzime në analizën financiare të këtyre viteve për shkak të moskonsiderimit të huave si burime për blerjen e pasurisë apartament.

**62.3.** Në përfundim, pas rishikimit të analizës financiare, rezultati i periudhës 1992 – 2003 rezulton pozitiv, ndërsa për periudhën 2004 – 2016 rezulton në vlerën -6.711.323 lekë, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë, balancë e cila është penalizuese për subjektin. Vlen të theksohet se edhe balanca negative e konfirmuar nga subjekti në analizën financiare të paraqitur prej tij prej 1.725.043 lekësh është penalizuese dhe në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, referuar standardit të konsoliduar të organeve të vlerësimit.

Periudha	1. Pasuri	2. Të ardhura	3. Shpenzime	Mundësia për kursim (2-1-3)
1992 – 2003	2,442,799	7,855,875	4,145,632	1,267,444
2004	495,708.92	1,491,644	1,841,595	-845,660
2005	8,240,122	7,511,812	1,045,828	-1,774,138
2006	586,523.24	1,814,936	1,355,582	-127,169
2007	797,778.25	5,877,381	6,082,706	-1,003,104
2008	-989,621	1,491,485	2,390,092	91,015

2009	206,967	1,609,396	1,584,174	-181,744
2010	388,786	1,805,113	4,070,748	-2,654,422
2011	298,886	1,928,741	1,499,251	130,604
2012	386,089	1,830,749	1,382,159	62,501
2013	32,229	1,817,057	1,640,886	143,942
2014	670,266	2,217,087	1,671,907	-125,086
2015	144,735	2,199,945	1,905,428	149,782
2016	498,266	4,106,594	3,120,351	487,977

### Vlerësim përfundimtar i kontrollit të pasurisë

**63.** Në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit, z. Kujtim Bashaj, nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas parashikimit të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk përmbush kriteret e nenit 33 të këtij ligji, për shkak se: (i) ka kryer deklarime të pasakta në përputhje me ligjin (shkronja “a” e pikës 5); (ii) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit (shkronja “b” e pikës 5); (iii) nuk ka vërtetuar se nuk është në kushtet e parashikimit të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës në lidhje me mjetin në përdorim në pronësi të motrës së tij K. B., përdorimin e të cilit e ka fshehur në deklaratën *Vetting*; (iv) në mënyrë të përsëritur ka marrë kredi për të shlyer huat dhe hua për të shlyer kreditë, me qëllim justifikimin e shlyerjes së tyre me të ardhura të ligjshme.

### KONTROLLI I FIGURËS

**64.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar raportin nr. \*\*\* prot., datë 3.3.2021, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Kujtim Bashaj, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.3.2021, të KDZH-së, nga ku rezulton se: (i) formulari i deklaratimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Në konkluzion të këtij raporti, AKSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Kujtim Bashaj.

#### 64.1. Hetimi i Komisionit

- Pasi është kërkuar përditësimi i të dhënave, ka rezultuar se nuk disponohen të dhëna të përditësuara për subjektin Kujtim Bashaj.
- SPAK-u<sup>53</sup> ka informuar se në emër të z. Kujtim K. Bashaj/Basha nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

<sup>53</sup> Shihni shkresat nr. \*\*\* prot., datë 11.11.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 4.7.2023, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

- Gjatë hetimit, Komisioni ka kryer verifikime në lidhje me shtetasin E. Gj., për të cilin kishte të dhëna se ishte përfshirë në veprimtari kriminale dhe në përfundim nuk u evidentuan kontakte të subjektit me këtë shtetas<sup>54</sup>.

**64.2.** Në procesin e vlerësimit përfundimtar të kriterit të figurës, Komisioni nuk evidentoi prova, fakte dhe rrethana që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit për shkak të veprimtarisë korruptive apo kontakteve me persona të përfshirë në krimin e organizuar, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit Kujtim Bashaj është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**65.** Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Kujtim Bashaj, bazuar në: raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë me nr. \*\*\* prot., datë 23.5.2023, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 2.6.2023; informacionin e marrë nga burime të ligjshme; kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**66.** Raporti për analizimin e aftësive profesionale të kryer nga KLP-ja është bazuar në: formularin e vetëdeklarimit dhe dokumente shoqëruese të formularit të vetëdeklarimit; tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit; 5 dosje të përzgjedhura me short, të shtjelluara hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ, pas analizës së të cilave Komisioni nuk evidentoi problematika, ashtu sikurse edhe KLP-ja në raportin e saj.

**67.** Sa i takon të dhënave nga burimet arkivore për subjektin e rivlerësimit Kujtim Bashaj rezulton se ndaj tij nuk është marrë ndonjë masë disiplinore. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka konfirmuar se ndaj subjektit të rivlerësimit Kujtim Bashaj janë regjistruar dy kallëzime penale për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, i vitit 2016 dhe 2017, për të cilët është vendosur mosfillim procedimi penal. Subjektit iu kërkua të japë sqarime dhe dokumente nëse është bërë ankim.

**67.1.** Në parashtrimet e tij, sa i përket ankimeve ndaj vendimeve të mosfillimit, subjekti sqaroi se vendimet e mosfillimit i përkasin kallëzimeve nr. \*\*\* të vitit 2016 dhe nr. \*\*\* të vitit 2017, të administruara në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për të cilat rezulton se vetëm për njërin prej tyre, konkretisht ndaj vendimit të mosfillimit nr. \*\*\*, datë 27.2.2017, është ushtruar ankim në Gjykatë dhe është shqyrtuar e lënë në fuqi vendimi i mosfillimit në të tria shkallët e gjykimit.

**67.2.** Në mbështetje të sqarimeve subjekti paraqiti *email*-in nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me anë të të cilit njoftohet z. Kujtim Basha se vendimi i mosfillimit nr. \*\*\* i vitit 2016 nuk është ankimuar, ndërsa vendimi i mosfillimit nr. \*\*\* i vitit 2017 është ankimuar nga kallëzuesi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.5.2017, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, si dhe ndaj këtij të fundit, pasi është paraqitur rekurs, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranim rekursi. Bashkëngjitur janë kopje të: dy vendimeve të mosfillimit; vendimit të Gjykatës së Apelit nr. \*\*\*, datë 6.11.2017, i cili ka lënë në fuqi vendimin nr. \*\*\*, datë 2.5.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; vendimit<sup>55</sup> nr. \*\*\*, datë 18.4.2023, të Gjykatës së Lartë, me anë të të cilit është vendosur mospranimi i rekursit kundër vendimit nr. \*\*\*, datë 6.11.2017, të Gjykatës së Apelit Shkodër.

<sup>54</sup> Trajtuar hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ.

<sup>55</sup> Ky vendim gjendet edhe në sistemin e Gjykatës së Lartë <http://www.gjykataelarte.gov.al/>



**67.3.** Sektori i Protokoll-Arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.1.2021, ka dërguar informacion se për subjektin e rivlerësimit përgjatë periudhës 2006 – 2020 janë regjistruar 4 ankesa, konkretisht:

- ankesa nr. \*\*\*, viti 2013, e shtetases N. S., e cila është pranuar nga drejtuesi i Prokurorisë dhe prokurori dhe është zëvendësuar oficeri i policisë gjyqësore për zvarritje;
- ankesa nr. \*\*\*, viti 2016, e shtetases B. B., e cila lidhet me një subjekt të dënuar dhe ndaj të cilit ka vendim dënimi;
- ankesa nr. \*\*\*, viti 2016, e shtetasit P. Gj., për të cilën është marrë edhe vendimi i mosfillimit të procedimit penal për kallëzimin nr. \*\*\*, viti 2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë<sup>56</sup>;
- ankesa nr. \*\*\*, viti 2018, e cila i është dërguar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, pasi ky shtetas po vuan dënimin në IEVP-në Rrogozhinë dhe kompetente është Gjykata dhe Prokuroria që ka nën juridiksion territorial institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale.

**67.4.** Pas verifikimit të akteve përkatëse vërehet se ankuesit janë orientuar për zgjidhjen në organet përkatëse, për të cilat Komisioni vlerësoi se nuk përmbajnë fakte dhe rrethana për hetime të mëtejshme.

**68.** Pranë Drejtorisë Ekonomike dhe të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë ka të dhëna për vlerësimin e punës së këtij prokurori për vitet 2012 – 2016 në nivelin “shumë mirë”.

**69. Pasi ka analizuar të dhënat si më sipër, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vlerësuar subjektin e rivlerësimit Kujtim Bashaj, si vijon:**

#### **Aftësitë profesionale**

a) *Njohuritë ligjore.* Subjekti i rivlerësimit tregon korrektësi në zbatim të ligjit. Analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e harmonizuar atë me faktin penal apo rrethanat që përcaktojnë masën e dënimit.

b) *Arsyetimi ligjor.* Subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e arsyetuara prej subjektit janë të kuptueshme. Në të gjitha aktet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe dosjet e shortuara janë analizuar në mënyrë të hollësishme ose të përmbledhur elementet e veprës penale objekt hetimi. Niveli i arsyetimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

#### **Aftësitë organizative**

a) *Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë.* Subjekti i rivlerësimit, gjatë periudhës së rivlerësimit, ka trajtuar gjithsej 760 çështje penale. Në referencë të të dhënave statistikore dhe obligimeve të tij ligjore si zëvendësdrejtues, konstatohet se prokurori ka përballuar ngarkesë pune normale gjatë periudhës së rivlerësimit. Nga analiza e pesë çështjeve të përzgjedhura me short, qëndrimi i tij është brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal. Prokurori, subjekt rivlerësimi, ka përballuar ngarkesën e punës me efikasitet. Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit është efikas dhe efektiv. Në këtë drejtim duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

b) *Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.* Subjekti i rivlerësimit merr pjesë në gjykim si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë. Konstatohet se tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

c) *Aftësia për të administruar dosjet.* Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në

---

<sup>56</sup> Shihni edhe shkresën e Prokurorisë së Përgjithshme nr. \*\*\* prot., datë 21.7.2023, e cila ka përcjellë informacion nga prokuroritë e rretheve, në dosjen e Komisionit.

rend kronologjik, na njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe disponimin e Gjykatës. Rezulton për: dosjen nr. 1, kohëzgjatja e hetimeve 12 ditë; dosjen nr. 2, kohëzgjatja e hetimeve 13 ditë; dosjen nr. 3, kohëzgjatja e hetimeve 2 muaj e 11 ditë; dosjen nr. 4, kohëzgjatja e hetimeve 2 vjet, 2 muaj e 15 ditë (është lapsus pasi është 2 muaj e 15 ditë); dosjen nr. 5, kohëzgjatja e hetimeve 4 muaj e 5 ditë.

### **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

a) *Etika në punë.* Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

b) *Integriteti.* Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Kujtim Bashaj, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara sipas shortit, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) *Paanësia.* Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

### **Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

a) *Aftësitë e komunikimit.* Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në format letër dhe në 3 dokumentet e dorëzuara prej tij, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) *Aftësia për të bashkëpunuar.* Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e Prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) *Gatishmëria për t'u angazhuar.* Subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në 4 seminare/trajnime në total në Shkollën e Magjistraturës dhe në 4 trajnime të kryera disa brenda dhe disa jashtë periudhës së rivlerësimit, nga agjenci të ndryshme të ligjit.

### **70. Informacioni i marrë nga burime të ligjshme, ku si të tilla janë konsideruar:**

- Tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, nga analiza e të cilave rezultuan të njëjtat gjetje të konstatuara edhe nga KLP-ja në raportin e saj.

- Dy denoncime nga publiku të shtetasve P. D. Ll.<sup>57</sup> dhe Th. S. M., nga verifikimi i të cilave nuk rezultuan problematika.

- Ministria e Drejtësisë<sup>58</sup> ka informuar se pas verifikimeve të kryera në arkivin për periudhën 2019 – 2023, pasi fondi arkivor 2006 – 2018 është një fond i papërpunuar dhe si i tillë nuk mund të bëhet evidentimi i informacionit të kërkuar, nuk janë evidentuar të dhëna për subjektin Kujtim Bashaj (Basha).

**71.** Në përfundim, për subjektin është vlerësuar se: (i) ka treguar aftësi të mira profesionale sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016; (ii) ka treguar aftësi të mira organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016; (iii) ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016; (iv) ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional sipas nenit 76 të

<sup>57</sup> Shihni denoncimin protokolluar me nr. \*\*\*, datë 8.1.2019.

<sup>58</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.7.2023, të MD-së në dosjen e Komisionit.

ligjit nr. 96/2016. Për rrjedhojë, sipas shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

## **SEANCA DËGJIMORE**

**72.** Në datën 11.10.2023, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Kujtim Bashaj, në përfundim të së cilës ai kërkoi konfirmimin në detyrë. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoji relatoren e çështjes, komisioneren Firdes Shuli, e cila rekomandoi se ndaj subjektit të rivlerësimit duhet të merrej masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Kujtim Bashaj dhe shpalli vendimin në seancën e datës 13.10.2023, sipas pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

## **QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**73.** Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016. Në të gjitha komunikimet, subjekti ka qenë i gatshëm për t’u përgjigjur brenda afateve të caktuara. Por ka pasur raste që nuk ka dhënë shpjegime ose ka dhënë shpjegime/deklarime jo në mënyrë shteruese dhe jo në koherencë me deklaratimet ndër vite dhe atë *Vetting*, qëndrim i cili është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

## **KONKLuzion PËRFUNDIMTAR**

**74.** Bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe në parimin e proporcionalitetit sipas pikës 5 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit Komisioni krijoi bindjen se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Kujtim Bashaj nuk arrin nivelin kualifikues për sa i takon kriterit të pasurisë, pasi ka kryer deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme, sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Kujtim Bashaj ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës sipas nenit 59/b të ligjit.

- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Kujtim Bashaj ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 59/c të ligjit.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në praninë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit të pikës 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 58 dhe në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Kujtim Bashaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 18.10.2023.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Olsi KOMICI**  
**Kryesues**

**Firdes SHULI**  
**Relatore**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Jonida Vrana*